



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Gjuhë Angleze” me profile:

**"Gjuhë Angleze"; Përkthim dhe Interpretim"; "Studime Britanike dhe
Amerikane"**

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Valbona Loshi (Softa)

Dr. Alda Jashari (Cicko)

Dhjetor / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Gjuhë Angleze" me profile në: "Gjuhë Angleze"; Përkthim dhe Interpretim"; "Studime Britanike dhe Amerikane"**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës Angleze
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Gjuhë Angleze me profile; gjuhë angleze, përkthim dhe interpretim, studime britanike dhe amerikane
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 359, datë 21.09.1991
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr.297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i I- rë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	46 PAE dhe 28 PAK (62% /38 %) Bazuar në ngarkesën mësimore rezultojnë: 84.7 % PAE /15.3 % PAK
18	Numri i studentëve: *	- 2019 - 2020: 232 studentë; - 2020 - 2021: 216 studentë; - 2021 - 2022: 219 studentë;
19	Komente / të tjera:	

*Numri i studentëve është dhënë në total për të gjitha profilet

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 207, datë 30.05.1957. Universiteti i Tiranës zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Universiteti i Tiranës ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 26.10.2022. Universiteti i Tiranës është i organizuar në 8 Njësi Kryesore.

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze me profile; gjuhë angleze, përkthim dhe interpretim, studime britanike dhe amerikane, licensuar fillimisht sipas VKM Nr. 359, datë 21.09.1991 “PËR RIORGANIZIMIN E DISA FAKULTETEVE TË UNIVERSITETEVE”, si dega e “Gjuhës Angleze”. Institucioni nuk disponon ndonjë akt ligjor mbi riorganizimin e programit me profile. Sipas Urdhërit Nr. 297, datë 20.07.2012 “ *Për regjistrimin e formës së programeve të studimeve “Bachelor”, “Master Profesional”, dhe “Master i Shkencave” të Universitetit të Tiranës*”, regjistrimi i formës së diplomës për këtë program studimi rezulton me emërtime sipas profileve, Bachelor në Gjuhë Angleze me profile; gjuhë angleze, përkthim dhe interpretim, studime britanike dhe amerikane.

Programi Bachelor në "Gjuhë Angleze" është program i ciklit të parë të studimeve, i cili ofrohet nga Departamenti i Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës. Organizimi, ndarja dhe strukturimi i programit të studimit “Bachelor në “Gjuhë Angleze” me profile "Gjuhë Angleze", "Përkthim-Interpretim" dhe “Studime Britanike dhe Amerikane”, mbështetet plotësisht në legjislacionin në fuqi, përmbush detyrimet e përcaktuara në Ligjin Nr.80/2015 dhe specifikat e përcaktuara në VKM nr.40/2018 "Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL", sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Lëndët dhe modulet e programit të ciklit të parë Bachelor vlerësohen me kredite (ECTS), në përputhje me ligjin Nr.80/2015 dhe Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve. Kohëzgjatja normale e programit të ciklit të parë është tre vite akademike, të ndara në 6 semestra, me nga 15 javë mësimore secila. Kreditet e siguruar përgjatë këtij cikli janë 180, të shpërndarë në mënyrë të barabartë, përkatësisht 60 kredite për vit.

Programi Bachelor në "Gjuhë Angleze" është hartuar dhe ofrohet në përputhje me objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Fakultetit të gjuhëve të Huaja, e cila në misionin e saj synon t'i shërbejë shoqërisë nëpërmjet një formimi me cilësi të lartë për ti pajisur studentët me aftësi të mira profesionale, në përshtatje me kërkesat e tregut të punës, garantimit të suksesit të tyre dhe rritjes së aktivitetit kërkimor me standarte ndërkombëtare. Programi i studimit “Bachelor në “Gjuhë Angleze”, përmes lëndëve dhe moduleve të ofruara synon t'i pajisë studentët me dijet, njohuritë dhe shprehitë gjuhësore, letrare dhe komunikative bazë, sikurse dhe t'i aftësojë ata në fusha të veçanta si përkthimi dhe mësimdhënia, duke ju ofruar mundësi punësimi në një sferë gjerë profesionesh dhe specialitetesh.

Stafi akademik efektiv i DGJA përbëhet nga një personel prej (47) pedagogësh nga të cilët (4) profesorë, (3) profesorë të asociuar, (35) doktorë shkencash dhe (5) Msc, ndërkohë që numri i pedagogëve të punësuar me kontratë është (42). Personeli akademik i DGJA është i angazhuar për zhvillimin dhe rritjen akademike në shërbim të programit të studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, botimit të artikujve shkencorë në revista shkencore të huaja të indeksuara dhe me sistemin e vlerësimit të punimeve nga një Bord Editorial paraprak, si edhe pjesëmarrjen në trajnime vendase dhe të huaja me karakter kërkim-zhvillimi në fushën e studimeve të gjuhës angleze. Studentëve të programit Bachelor në "Gjuhë Angleze" u janë vënë në dispozicion auditorë leksionesh me kapacitet 218 vende, të pajisur me tryeza inteligjente, projektor, system audio dhe Wi-Fi. Auditorët, laboratorët, sallat dhe mjediset mbështetëse i shërbejnë maksimalisht zhvillimit të programit mësimor "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" me profile: "Gjuhë Angleze", "Përkthim-Interpretim" dhe "Studime Britanike dhe Amerikane".

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës, në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në përputhje me "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit, 2017" ka aplikuar më datë 26.10.2021 nëpërmjet sistemit AMS për nisjen e procedurave për akreditimin e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" me profile: "Gjuhë Angleze", "Përkthim dhe Interpretim", "Studime Britanike dhe Amerikane". Procedura për akreditimin e këtij programi studimi ka nisur më datë 31.01.2022. Ky është procesi i parë i vlerësimit të standarteve të cilësisë për këtë program studimi.

Agjensia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë ngriti grupin e punës, në përbërjen e të cilit u përzgjedhën dy ekspertë për procesin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ), i cili përbëhet nga Dr. Valbona Loshi (Softa), pedagoge në Kolegjin Universitar "Wisdom" dhe Dr. Alda Jashari (Cicko) pedagoge në Universitetin "Fan Noli" u kontaktuan nga ASCAL në muajin Korrik 2022 nga përfaqësuesja e Agjensisë Znj. Majlinda Demirneli, e cila ishte e pranishme gjatë vizitave në institucion. Grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh me procedurën e vlerësimit për shqyrtimin e Dosjes së Vetëvlerësimit, kryerjen e vizitës në institucion dhe përpilimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Gjatë takimit të zhvilluar në ASCAL dhe më datë 2 Gusht, 2022, ekspertëve të jashtëm iu vu në dispozicion materiali i plotë i depozituar për vlerësim sipas procedurës së ASCAL. Pas kohës së nevojshme për procesin e shqyrtimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit shoqërues të tij, nga i cili u përcaktuan edhe pyetjet respektive, u përpilua agenda e vizitës në Fakultetin e Gjuhëve e Huaja, në datat 13-14 Shtator, 2022. Gjatë vizitave në institucion, Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, iu vu në dispozicion një sallë ku u zhvilluan të gjitha takimet e parashikuara sipas agjendës. Pas këtij procesi, GVJ kërkoi dokumentacion shtesë për diskutimet e ngritura gjatë vizitës, i cili u dorëzua në ASCAL më datë 19.09.2022. GVJ, pasi rishikoi dokumentacionin e plotë dhe në reflektim të takimeve që pati në institucion, paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas fushave, standarteve dhe

kritereve përkatëse, për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" me profile: "Gjuhë Angleze", "Përkthim dhe Interpretim", "Studime Britanike dhe Amerikane". Në fund të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, janë përfshirë nëpërmjet një analize, pikat e forta dhe të dobëta të programit të studimit, si dhe rekomandimet që kanë dalur nga procesi i vlerësimit të jashtëm. Raporti i mëposhtëm është një sintezë e vlerësimit të programit të studimit nga dy ekspertet e vlerësimit të jashtëm.

Lista e shkurtimeve

DVV-Dosja e Vetëvlerësimit

DGJA -Departamenti i Gjuhës Angleze

ECTS-European Credit Transfer System

FGjH- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

GVB- Grupi i vlerësimit të brendshëm

GVJ - Grupi i vlerësimit të jashtëm

MAS-Ministria e Arsimit dhe Sportit

NJSBC-Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

QSHA-Qendra e Shërbimeve Arsimore

RVB-Raport i Vlerësimit të Brendshëm

STP-Studimi i Tregut të punës

SZhFGjH- Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

SZhUT- Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 03.11.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 52/140 Prot, datë 03.11.2022. Universiteti i Tiranës nuk ka dërguar komente, sugjerime në lidhje mbi Draft Raportin, sipas Manualit 2017, si dhe përcaktimit në agjendën e detajuar të vlerësimit. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: "Gjuhë Angleze" me profile: "Gjuhë Angleze", Përkthim - Interpretim" dhe "Studime Britanike dhe Amerikane"

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Referuar Raportit të Brendshëm të Vlerësimit (RVB), si edhe duke u mbështetur në dokumentacionin shoqërues në Dosjen e Vetë vlerësimit, (DVV), Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë publik "Universiteti i Tiranës", referuar në këtë Raport Vlerësimi me shkurtimin (UT), i licencuar me VKM nr. 207, datë 30.05.1957 dhe i riorganizuar në vitin 1991 me VKM nr.359, dt.21.09.1991 "Për riorganizimin e disa fakulteteve të universiteteve", duke ndarë Fakultetin e Gjuhëve të Huaja nga Fakulteti i Histori- Filologjisë, ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Nenin 57, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Kuadrin Ligjor për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor (Ligji Nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë") duke ofruar programe studimi të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare.
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	GVJ u informua nga vizita në institucion se deri në vitin 1996 programet e studimit përgatishnin vetëm mësues të gjuhës angleze dhe duke nisur nga ky vit u ofrua për herë të parë programi 4-vjeçar me profilet "Mësuesi", "Përkthim dhe Interpretim" dhe "Studime Britanike dhe Amerikane", nga i cili brezi i fundit i diplomuar ishte në vitin 2008. Ndërsa procesi i Bolonjës me brezin e parë të studentëve të regjistruar në programin e studimit Bachelor "Gjuhë Angleze" me profile: "Gjuhë Angleze"; "Përkthim dhe Interpretim"; "Studime Britanike dhe Amerikane" nisi në vitin 2005. GVJ konstaton se Programi Bachelor në "Gjuhë Angleze" me profile:"Gjuhë Angleze"; "Përkthim dhe Interpretim"; "Studime Britanike dhe Amerikane" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, 2021-2024, përcakton se nëpërmjet promovimit të studimeve dhe ridimensionimit e veprimtarisë mësimore,



	<p>kërkimore dhe kulturore, synohet fuqizimi i institucionit dhe njësive bazë të tij, (Ref. 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, 2021-2024). GVJ konstaton se neni 4 i Statutit të UT-së shpreh qartë vizionin se institucioni synon të mbetet një model i institucioneve publike të arsimit të lartë, duke ofruar edukim me në qendër studentin, për një karrierë produktive dhe qytetare, si dhe duke i formuar ata me përgjegjshmëri për një shoqëri globale, (Ref. 1.2: Statuti i Universitetit të Tiranës).</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në DVV, GVJ konstaton se Programi "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" me profile në: "Gjuhë Angleze", "Përkthim dhe Interpretim" dhe "Studime Britanike dhe Amerikane" është program i ciklit të parë të studimeve i organizuar me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe me një total 180 Kredite (ECTS), i cili ofrohet nga Departamenti i Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. GVJ konstaton se Neni 3 i Rregullores për Organizimin e Programit të Studimit, Bachelor në "Gjuhë Angleze" përcakton se ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin e UT-së, strategjinë e zhvillimit të tij dhe Rregulloren për organizimin e programit të studimit. (Ref 1.6: Rregullore për organizimin e Programit të Studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze").</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" është hartuar dhe ofrohet në përputhje me objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Fakultetit të gjuhëve të Huaja, e cila në misionin e saj synon t'i shërbejë shoqërisë nëpërmjet një formimi me cilësi të lartë për të pajisur studentët me aftësi të mira profesionale, në përshtatje me kërkesat e tregut të punës, garantimit të suksesit të tyre dhe rritjes së aktivitetit kërkimor me standarte ndërkombëtare (Ref. 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, 2021-2024).</p> <p>GVJ konstaton se Rregullorja e Departamentit të Gjuhës Angleze, në Nenin 4 të saj përcakton synimin që nëpërmjet programeve të studimit që ky departament ofron, të formojë specialistë në mësimdhënien e gjuhës angleze, përkthim–interpretim, studime britanike dhe amerikane dhe kërkim shkencor në fushat gjuhësore, kulturore dhe letrare në përgjigje dhe në përshtatje me tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe lokal. (Ref. 1.3: Rregullore për Organizimin dhe Funkcionimin e Departamentit të Gjuhës Angleze).</p> <p>Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe dokumentacioni</p>




	<p>shoqërues GVJ konstaton se programi i studimit është hartuar me qëllim zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar, motivuar me numrin e lartë të të diplomuarve nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në Programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze", të punësuar kryesisht në sektorin privat, por edhe atë publik, në drejtimet: turizëm, mësuesi dhe përkthim-interpretim.</p> <p>(Ref. 1.10: Studim i Tregut të punës për studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja).</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht
			X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezulton se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" është hartuar dhe ofrohet në përshtatje edhe në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit të UT-së 2018-2023, e cila përcakton linjat themelore të veprimit dhe krijon kornizën kuadër për performancën e UT-së për vitet 2018-2023 (Ref. 1.4: Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, 2018-2023). GVJ konstaton se nëpërmjet programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" që Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ofron, është mbështetur në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të UT-së dhe Strategjisë së Zhvillimit të Fakultetit të gjuhëve të Huaja, sigurohet ofrimi i kompetencave të studentëve në rrafshin global dhe dhënia e kontributit real në prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të aplikuar. Rregullorja për Organizimin e Programit të studimit parashtron në Nenin 3 synimin që të krijojë një kuadër të plotë dhe të qartë për programin e studimit. (Ref. 1.6: Rregullore për organizimin e Programit të Studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze").</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të</p>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentacionin shoqërues të tij, GVJ vëren se drejtimet prioritare akademike të institucionit janë përcaktuar qartë në Statutin e UT-së (Neni 4, 5,6), Rregulloren e UT-së (Neni 31,35,36,37 për organizimin e studimeve), si edhe Rregulloren për Organizimin e Programit të Studimit, Bachelor në "Gjuhë Angleze" (Neni 3). Neni 5 i Statutit (UT) përcakton se institucioni ofron një gamë të plotë të programeve</p>

<p>këtyre të fundit.</p>	<p>të studimit të nivelit Bachelor, Master dhe studime doktorale, si edhe shpreh qartë qëllimin për zhvillimin e shoqërisë përmes tre shtyllave: kërkim shkencor, edukim dhe shërbim ndaj publikut. (Ref. 1.2: Statuti i Universitetit të Tiranës; Ref. 2.1: Rregullore e Universitetit të Tiranës). Nga verifikimi që GVJ i bëri i dokumentacionit në DVV rezultojnë se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" është hartuar dhe ofrohet në përputhje me drejtimit prioritar akademike të përcaktuara qartë në Statutin dhe Rregulloren e Institucionit. (Ref. 1.6: Rregullore për Organizimin e Programit të Studimit, Bachelor në "Gjuhë Angleze").</p> <p><i>Nga shqyrtimi materialeve të depozituara pranë ASCAL, GVJ konstatoi se nuk disponohet dokumentacion (Vendim) për licensimin e çeljes së këtij programi studimi dhe emërtimin e tij. GVJ u informua nga vizita në institucion, se programi i studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" me profile në: "Gjuhë Angleze", "Përkthim dhe Interpretim" dhe "Studime Britanike dhe Amerikane", ka ardhur si rrjedhojë e kalimit nga sistemi universitar 4-vjeçar në sistemin e përshtatur sipas Procesit të Bolonjës (3+2) mbështetur në ndryshimet në kuadrin ligjor për arsimin e lartë. (Ref. Pika 42/43: Kalimi i programit të studimit mbi bazën e parimeve të sistemit të Bolonjës).</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e Programit të Studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" me profile në: "Gjuhë Angleze", "Përkthim dhe Interpretim" dhe "Studime Britanike dhe Amerikane" (emërtimet e programit të studimit të vendosura sipas Urdhrit Nr.297, dt. 20.07.2012, "Për Regjistrimin e Formave të Diplomave të Programeve të Studimeve të UT-së"), ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit mbështetur në Statutin e UT-së, (Neni 7/pika b), ku përcaktohet liria akademike e institucionit, e cila garantohet nëpërmjet të drejtës për të hartuar dhe zhvilluar programe studimi, si edhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore, me Rregulloren e UT-së, (Neni 31,35,36,37) dhe Rregulloren për Organizimin e Programit të Studimit (Neni 3, pika 3.1,3.2,3.3). (Ref. 1.2: Statuti i Universitetit të Tiranës; Ref. 2.1: Rregullore e Universitetit të Tiranës. Ref.1.6: Rregullore për Organizimin e Programit të Studimit, Bachelor në "Gjuhë Angleze").</p> <p>GVJ konstaton nga vizita në institucion dhe dokumentacioni shoqërues se emërtimi i Programit të Studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" pavarësisht se nuk mbështetet në një vendim për licensimin e tij, ka ardhur si rrjedhojë e kalimit nga sistemi</p>

universitar 4-vjeçar në sistemin e përshtatur sipas Kartës së Bolonjës (3+2), (Ref. Pika 42/43 -Kalimi i programit të studimit mbi bazen e parimeve të sistemit të Bolonjes).

Nga vizita në institucion GVJ konstaton se institucioni ka ndërmarrë inisiativa zyrtare që ky emërtim të standartizohet. Gjithashtu u konstatua nga vizita në institucion se FGjH në kuadër të promovimit të tij ka hartuar udhërrëfyesin për studentët ku specifikohen detajet e programit të studimit, si edhe qartëson maturantët mbi emërtimin e Programit të studimit në "Ditët e Informimit", në Panairin "Work and Study". GVJ u informua se studentët e regjistruar në programin e studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" me profile në: Gjuhë Angleze", "Përkthim dhe Interpretim", "Studime Britanike dhe Amerikane", zhvillojnë takime në javën e parë të viti akademik me pedagogët, studentët e diplomuar dhe ata që kanë qenë pjesë e mobilitetit, si edhe përfaqësues të Zyrës së Karrierës, të cilat i njohin studentët me emërtimin e plotë të programit të studimit.

GVJ konstaton nga vizita në institucion se FGjH ka kryer veprime për standartizimin e emërtimit të programit të studimit në çdo burim dhe akt nënligjor, sipas regjistrimit të formës së diplomës dhe lëshimit të saj nga institucioni sipas emërtimit: "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" me profile në: Gjuhë Angleze", "Përkthim dhe Interpretim", "Studime Britanike dhe Amerikane" (Ref. VKM nr.866, datë 23.10.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.638, datë 22.07.2015 "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë" Procedura e ASCAL -Aplikimi, kontrolli i të dhënave institucionale dhe i programit të studimit).



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3


Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në mënyrë të përpunueshme me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e	Bazuar në dokumentacionin e depozituar në DVV konstatohet nga GVJ se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" ka objektiva të përcaktuara qartë për

<p>studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>formimin e studentëve, të cilat garantojnë formimin gjuhësor dhe shkencor me drejtim human të specialistëve, aftësinë për të përdorur në praktikë njohuritë e fituara në fushën e përkthimit, interpretimit studimeve britanike dhe amerikane, zhvillimin e koncepteve shkencore të shprehive të integruara me natyrë gjuhësore, letrare dhe kulturore. Programi i studimit në "Gjuhë Angleze" hedh bazat për studimin e thelluar në ciklin e dytë të studimeve me kahe të posaçme profesionale. (Ref.1.6 Rregullore për Organizimin e Programit të Studimit, Bachelor në "Gjuhë Angleze", neni 3).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Mbështetur në RVB dhe dokumentacionin e depozituar në DVV, rezulton se UT ka kryer studimin e tregut të punës në periudhën Mars–Prill 2018 në nivel institucioni (Ref 1.9 Studim i Tregut të punës, UT) dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka kryer studimin e tregut të punës në nivel fakulteti, (Ref 1.10 Studimi i Tregut të punës për studentët e FGJH, 2021). Studimi i tregut të punës për studentët e diplomuar në FGJH nëpërmjet grumbullimit të të dhënave nga burime zyrtare si QSHA dhe Portali për Mësuesin evidenton se numri i të diplomuarve në gjuhën angleze është ai më i larti që plotëson nevojat e tregut për punësim në sektorin publik në profilin e mësuesisë ku nga 480 mësues të gjuhëve të huaja të punësuar në sektorin publik të arsimit parauniversitar, 349 prej tyre kanë përfunduar studimet në Gjuhë Angleze.</p> <p>GVJ konstaton se studimi i tregut të punës së FGJH nxjer në pah mospërputhjen midis kërkesës dhe ofertës për punësim në profilin e mësuesisë në Arsimin parauniversitar publik, pasi kapaciteti dhe nevoja për mësues të gjuhëve të huaja në ciklin e arsimit parauniversitar publik është i ulët (për vitin 2020-2021 janë rekrutuar rreth 37% ose përafërsisht 1/3 e aplikantëve në Portalin për mësues).</p> <p>GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues, (Ref 1.10 Studimi i Tregut të punës për studentët e FGJH), përsa i përket të diplomuarve në profilin e përkthimit dhe interpretimit evidenton se nga anketimet e drejtuara Shtëpive Botuese dhe Agjensive të Përkthimit nga grupi i punës i STP së FGJH, këto të fundit janë përgjigjur në masën 100% se kanë të punësuar më shumë se një përkthyes të diplomuar në FGJH, ku mbizotërojnë të diplomuarit në gjuhë angleze. GVJ, vëren nga nga të dhënat e studimit nxjerë nga faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë se për vitin 2020-2021 ka patur 85 përkthyes të gjuhës angleze të</p>

	<p>afirmuar me certifikatë sigurie dhe 261 përkthyes të cilët nuk posedojnë një të tillë. GVJ, referuar STP së FGJH konstaton për punësimin e të diplomuarve në gjuhët e huaja se 75% e agjensive turistike kanë patur eksperiencë me punonjës të diplomuar në gjuhët e huaja nga një anketim i hartuar dhe administruar nga grupi i punës së STP të FGJH.</p> <p>Po ashtu GVJ konstatoi se në sondazhin në formë elektronike të zhvilluar me të diplomuarit e FGJH, të cilët kanë ndjekur studimet në periudhën kohore 2018-2021, rezulton nga të dhënat se 29% e të diplomuarve janë të punësuar në mësimdhënie, 7% në përkthim, 4% në sektorin e turizmit si agjent turistik dhe 24 % në "Call Centers" dhe në përqindje më të ulëta në drejtime të tjera. (Ref 1.10 Studimi i Tregut të punës për studentët e FGJH).</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionit mbështetës të tij, GVJ konstatoi nga shqyrtimi i planeve mësimore se struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" (Ref. 1.12 Aneks RVB, Plani mësimor i programit të studimit, Tabela 10), është përgjithësisht në funksion të objektivave në Rregulloren e Organizimit të Programit të studimit, (Ref.1.6: Rregullore e Organizimit të Programit të studimit neni 3,4 dhe 5) dhe Rregulloren e Departamentit (Ref: 1.3, Rregullore e Departamentit neni 4/pika 3.2/g) dhe kryesisht në funksion të Studimit të Tregut të Punës së FGJH dhe Strategjisë së zhvillimit të FGJH (Ref 1.10 Studimi i Tregut të punës për studentët e FGJH, REF. 1.5 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, 2021-2024).</p> <p>Për efekt të lehtësimit të nevojave të tregut të punës, Strategjia e Zhvillimit të FGJH angazhohet për zgjerimin e partneritetit, qëllimet e të cilëve janë në përputhje me ato të FGJH, në mënyrë që të mbështetet ndër të tjera edhe punësimi i të diplomuarve, (Ref 1.5, SZhFGJH, Objektivi 11). GVJ vëren se, megjithëse strategjia e FGJH është miratuar në Dhjetor të vitit 2021, institucioni i ka krijuar disa nga mekanizmat për të siguruar të gjithë objektivat lidhur me përgjigjen ndaj tregut të punës dhe lehtësimin e punësimit të studentëve, siç janë: krijimi i një forumi të përhershëm me punëdhënësit, zhvillimi i një instrumenti feedback për punëdhënësit dhe krijimi i bazës së të dhënave për të diplomuarit. (Ref 1.5. SZhFGJH, Objektivi 11. Pikat 11.1/ 1.2/ 11.6/ 11.7/11.8/ Ref. Faqja zyrtare e FGJH.</p>






	<p>www.fgjh.edu.al).</p> <p>GVJ vëren se Studimi i Tregut të Punës për të diplomuarit e FGjH, shtjellon mundësinë e ofrimit të programeve ndërdisiplinore të studimit të gjuhëve moderne, të cilat sigurojnë jo vetëm aftësi gjuhësore, por edhe aftësi të komunikimit dhe shkëmbimit ndërkulturor në një ekonomi të globalizuar si e sotmja. (Ref 1.10 Studimi Tregut të Punës Pika 5/ 5.1/5.2). GVJ konstaton se rezultatet e pritshme të të nxënit për programin e studimit Bachelor në gjuhë angleze, përgjithësisht garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen kryesisht nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Referuar RVB përcaktohet se Fakulteti i Gjuhëve të Huaja është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 2141, dt. 14.09.1991, "Për disa ndryshime në VKM nr.220, dt. 11.08.1982 "Për sistemin Arsimor".</p> <p>FGjH për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej 216 pedagogë, nga të cilët 132 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 15 kanë titullin "Profesorë", 22 kanë titullin "Profesor i Asociuar", 81 kanë gradën Dr. / PhD, dhe 14 Asistent Lektorë me Msc; dhe 84 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 3 kanë titullin "Profesor", 4 kanë titullin "Profesorë të Asociuar", 11 kanë gradën Dr. / PhD dhe 66 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Gjuhës Angleze, për vitin akademik 2021-2022, ka një total prej 89 pedagogësh, nga të cilët 47 janë personel akademik efektiv (PAE), 4 prej tyre kanë titullin akademik "Profesor " dhe 3 "Profesor i Asociuar"; 35 kanë gradë shkencore "Doktor i Shkencave" dhe 5 pedagogë të diplomuar në "Master i Shkencave", 1 prej të cilëve është doktorant. Dhe (42) pedagogë personel akademik me kontratë (PAK) dhe 1 personel ndihmës</p>




	<p>akademik, nga të cilët (5) janë të kategorisë Profesor, (8) me gradën Doktor i Shkencave dhe (29) MSc. (Ref.2.7 Aneks RVB. Tabela 1).</p> <p>GVJ, mbështetur në të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, konstaton se numri i stafit PAE me titull "Profesor" është 7 në të tre vitet akademike që shtrihet programi studimit. (Ref.1.14, Aneks RVB. Tabela 7. Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre)</p> <p>GVJ konstaton se personeli akademik i DGJA, në përgjithësi, është i angazhuar për zhvillimin dhe rritjen akademike në shërbim të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze nëpërmjet pjesëmarrjes në Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, publikimit të artikujve shkencorë në revista shkencore të huaja të indeksuara dhe me sistemin e vlerësimit të punimeve nga një Bord Editorial paraprak, si edhe pjesëmarrjen në trajnime vendase dhe të huaja me karakter kërkim-zhvillimi në lëmin e studimeve të gjuhës angleze. (Ref. 1.15 Raport Vjetor i FGJH për vitin akademik 2019-2020/ Ref 1.16 Raport Vjetor i FGJH për vitin akademik 2021-2022).</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar dhe mbështetur në RVB, konstatohet se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FGJH (Ref. 2.1.1 Rregullore e FGJH, Kreu III Neni 11-13, Organizimi, Struktura dhe Elementët e studimeve). Ky program studimi është klasifikuar në Nivelin e gjashë (6) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe në planin mësimor të tij përfshihen veprimtaritë formuese të kategorive (A-E) me lëndët përkatëse dhe kreditet sipas VKM 41 "Për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL-të (Ref. 1.17. Ligji 10247, dt.04.03.2010 "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve").</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Gjuhëve të Huaja, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare, sipas Ligjit 80/2015, sipas Kartës së Bolonjës dhe sistemit Evropian të transferimit të krediteve (ECTS), (Ref.1.3 Rregullore e Departamentit të Gjuhës Angleze. Kreu III, Nenet 14-18). Ref.1.6 Rregullore për Organizimin e</p>


udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programit të Studimit, Bachelor në "Gjuhë Angleze" Kreu II, Neni 4 dhe 5).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues në DVV, konstatohet nga GVJ, se Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka hartuar Rregulloren e brendshme të institucionit, si dokumentin më të rëndësishëm rregullator në nivel njëvite kryesore, (Ref.2.1.1 Rregullore brendshme e FGjH) dhe Rregulloren e Departamentit si njësi bazë ofruese e programit të studimit, e cila është në funksion të mbarëvajtjes dhe mbikëqyrjes së programit të studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze", me profile: "Gjuhë Angleze"; "Përkthim-Interpretim" dhe "Studime Britanike dhe Amerikane" (Ref. 1.3 Rregullore e Departamentit të gjuhës angleze Neni 5/e, Neni 11.1, Neni 12. Pika 12.1 dhe 12.2).</p> <p>Bazuar në RVB dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se koordinimi akademik i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" kryhet nga grupet mësimore- kërkimore, të cilat janë përgjegjëse për grup lëndët përkatëse që ofron program i studimit, asistohet nga personeli ndihmës akademik me karakter administrativ, sekretaria e departamentit dhe sekretaria mësimore. Nga informacioni i paraqitur në RVB, si edhe nga vizita në institucion, GVJ evidenton bashkëpunimin e DGjA me Njësinë e Vlerësimit të brendshëm të Cilësisë, si strukturë që realizon analiza periodike të vlerësimit të brendshëm të FGjH (Ref.1.20 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT).</p>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues, GVJ konstaton se FGjH ka nënshkruar për periudhën 2016-2020, 38 marrëveshje


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>bilaterale dhe për periudhën kohore 2018 -2022 ka nënshkruar 31 të tilla me institucione brenda dhe jashtë vendit. GVJ konstaton se UT është angazhuar si institucion partner në disa programe bashkëpunimi të Komisionit evropian si Tempus, Erasmus Mundus Action 2, IPA, dhe është institucion partner në projektet evropiane Joineu-SEE, Basileus, Eureqa etj, si dhe ka nënshkruar marrëveshje për Programin Erasmus +KA107, UT . GVJ konstaton shkallën e lartë e intensitetit të partneritetit të UT me universitete të huaja si NOVA, Portugali, Universiteti KEEL, Mbretëri e Bashkuar, Universiteti i Torinos, Itali etj. (Ref.1.22 Marrëveshje bilaterale dhe Erasmus + KA107, UT), me qëllim angazhimin e drejtëpërdrejtë të personelit akademik dhe studentëve në funksion të marrëveshjeve për programin e studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" me profile: "Gjuhë Angleze"; "Përkthim-Interpretim" ;" Studime Britanike dhe Amerikane". Po ashtu, GVJ konstaton nga vizita në institucion se FGjH ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe dhe agjensi të ndryshme, si edhe me aktorët e biznesit.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues të tij, GVJ konstaton se DGjA ka hartuar një raport lidhur me ecurinë dhe detyrimet kryesore për projektin Re@WBC, si edhe ka prezantuar një model aplikimi projekti në emër të UT duke propozuar personel akademik nga FGjH si staf i projektit (Ref.1.23 Raport Projekti Re@WBC.pdf). Nga vizita në institucion GVJ u informua se është krijuar rrjeti i brendshëm për kërkimin shkencor, nëpërmjet të cilit organizohen konferenca me institucione homologe, si edhe në bashkëpunim me agjensitë me të cilat institucioni është partner. Në kuadër të ndërkombëtarizimit janë fituar 2 projekte të mëdha dhe UT ka mbështetur financiarisht mobilitetin e stafit në pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare. Nga vizita në institucion GVJ mori informacionin se në një projekt në vitin 2019 me universitetin e Torinos kanë përfituar 31 pedagogë nga FGjH dhe raportet analitike hartohen në kuadër të projekteve Erasmus + si detyrim ligjor, por hartohen edhe në funksion të ndikimit të projekteve në rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të</p>	<p>GVJ konstaton se Programi i studimit Bachelor në gjuhë angleze nuk përmban në planin mësimor praktikën mësimore dhe për pasojë vendosja e marrëdhënieve zyrtare e bashkëpunuese midis FGjH dhe institucioneve punëdhënëse për kryerjen e praktikës mësimore nuk është në funksion të</p>




<p>programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>natyrës specifike të Programit të studimit. (Ref. 1.12 Aneks RVB. Tabela 10. Plani mësimor i programit të studimit).</p> <p><i>Pavarësisht se programi i studimit në Gjuhë Angleze e mbulon kategorinë e lëndëve plotësuese në masën e duhur sipas ligjit në nivelin 11%, (referenca 10-15%), GJV rekomandon që praktika profesionale në terren të përfshihet si një nga lëndët plotësuese (Kategoria D e veprimtarive formuese) të këtij programi studimi sipas VKM Nr. 41. dt 24.1.2018 'Për elementët e programit të studimit të ofruar nga IAL-të'.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>GJV konstaton se UT dhe FGjH ofrojnë trajnime të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. GJV konstaton ngritjen e qendrës virtuale të zhvillimit profesional dhe trajnimit në universitetin e Tiranës në faqen zyrtare elektronike të UT në linkun https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimit-dhe-zhvillimit-profesional/. GJV konstaton se Strategjia e zhvillimit të UT-së promovon të mësuarit gjatë gjithë jetës përmes propozimit të stazheve dhe moduleve profesionale për rikualifikim (Ref. 1.4 SZHUT 2018-2023.Pika 1.2.25) GJV konstaton nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion të tij se FGjH në përbërje të strukturës organizative të tij ka ngitur disa qendra dhe degë për të mbuluar nevoja të brendshme si dhe për shërbime ndaj të tretëve si "Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik", "Dega e Projekteve", "Dega e përkthimeve", "Dega e Qendrës së Gjuhëve të Huaja". (Ref. Struktura organizative https://unitir.edu.al/struktura-organizative-e-fakultetit-te-gjuheve-te-huaja/)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	--------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	--

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR


Standardi II.1

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al






përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Referuar dokumentacionit të paraqitur në DVV, GVJ konstaton se organizimi, ndarja dhe strukturimi i programit të studimit “Bachelor në “Gjuhë Angleze” mbështetet plotësisht në legjislacionin në fuqi, përmbush detyrimet e përcaktuara në Ligjin Nr.80/2015 dhe specifikat e përcaktuara në VKM nr.41. 2018 dhe i referohet Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, përcaktuar në nenin 31 të Rregullores së UT-së mbi Organizimin e Studimeve (Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës).</p> <p>Studimet e ciklit të parë shtrihen gjatë tre viteve akademike dhe ofrojnë 180 kredite, të ndara përkatësisht në 60 kredite për secilin vit. (Ref 2.2 Kurrikulat sipas Bolonjës, Tabela e informacionit) Hartimi i planit mësimor mbështetet në Rregulloren e Programit të Studimit dhe struktura e tij përcakton ndarjen e lëndëve/moduleve në semestra, numrin e krediteve për secilën lëndë dhe organizimin e tyre në leksione apo seminare. (Ref.4.1Vendim nr. 39 datë 04.04.2018 Bordi i Administrimit, neni 10).</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Mbështetur në informacionin e dhënë nga GVB dhe duke shqyrtuar dokumentacionin plotësues, konstatohet se programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, përmes lëndëve dhe moduleve të ofruara synon t'i pajisë studentët me dijet, njohuritë dhe shprehjet gjuhësore, letrare dhe komunikative bazë, sikurse dhe t'i aftësojë ata në fusha të veçanta si përkthimi dhe mësimdhënia, duke ju ofruar mundësi punësimi në një sferë gjerë profesionale dhe specialitetesh. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze)</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Përzgjedhja e lëndëve dhe moduleve siguron marrjen e njohurive më të thelluara në fusha të specializuara studimi duke nxitur procesin e mësimnxënies në mënyrë kritike përgjatë gjithë ciklit të studimeve. Formësimi i studentëve në disiplina specifike brenda programit (përkthim, komunikim, metodologji e mësimdhënies) rrit mundësitë e tyre për punësim si përkthyes, mësimdhënës apo specialistë në fushën e komunikimit. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze)</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në</p>	<p>Gjatë gjithë ciklit të parë të studimit synohet që formimi gjuhësor i studentëve të gjuhës angleze në nivel teorik dhe praktik të gërshetohet me marrjen dhe thellimin e njohurive në</p>

<p>fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>fusha dhe disiplina të veçanta të studimeve gjuhësore (gjuhësi e përgjithshme, fonetikë, gramatikë, leksikologji), letrare (hyrje në letërsi, letërsi angleze/amerikane) dhe historike dhe kulturore (histori, kulturë, qytetërim anglez/amerikan). (Ref 1.12 Aneks RVB Tabela 10 Plani mësimor i programit të studimit)</p> <p>Zhvillimi i kompetencave dhe aftësive në fushat profesionale si përkthim dhe mësimdhënie u krijon studentëve hapësira për të zgjedhur profilet dhe specialitetet e duhura për ciklet e mëtejshme të studimeve. (Ref. 1.12 Aneks RVB Tabela 10 Plani mësimor i programit të studimit)</p>																								
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Bazuar në ndarjen e veprimtarive në kategori formuese, institucioni ka parashikuar një ndarje për këtë program studimi si më poshtë: (ANEKS RVB TABELAT.pdf)</p> <table border="1" data-bbox="577 698 1353 1144"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Tipi</th> <th>IAL</th> <th>Standardi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë Bazë</td> <td>18.8 %</td> <td>15 – 20 %</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë karakterizuese</td> <td>57.7 %</td> <td>50 – 55 %</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Lëndë ndërdisiplinore / integruese</td> <td>11.1 %</td> <td>12 – 15 %</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>Lëndë plotësuese</td> <td>11.1 %</td> <td>10 – 15 %</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>Detyrime përmblyëse</td> <td>3.3 %</td> <td>3 – 5 %</td> </tr> </tbody> </table> <p>Megjithëse ndarja e lëndëve sipas kategorive të paraqitur në planin mësimor është kryesisht konform VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, <i>në të nuk është parashikuar një lëndë “praktikë profesionale” në kategorinë “D”.</i></p> <p><i><u>GVJ rekomandon</u> që të vlerësohet mundësia e përfshirjes së praktikës profesionale në planin mësimor të programit të studimit.</i></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit plotësues konstatohet se programi i studimit “Bachelor në “Gjuhë Angleze” është hartuar në përputhje me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM 879, datë 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave” Për elementët e programeve të studimit të ofruara në institucionet e arsimit të lartë”.(Ref 2.4 VKM nr. 879, datë 18.12.2019)</p>	Kategoria	Tipi	IAL	Standardi	A	Lëndë Bazë	18.8 %	15 – 20 %	B	Lëndë karakterizuese	57.7 %	50 – 55 %	C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	11.1 %	12 – 15 %	D	Lëndë plotësuese	11.1 %	10 – 15 %	E	Detyrime përmblyëse	3.3 %	3 – 5 %
Kategoria	Tipi	IAL	Standardi																						
A	Lëndë Bazë	18.8 %	15 – 20 %																						
B	Lëndë karakterizuese	57.7 %	50 – 55 %																						
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	11.1 %	12 – 15 %																						
D	Lëndë plotësuese	11.1 %	10 – 15 %																						
E	Detyrime përmblyëse	3.3 %	3 – 5 %																						



	Rregullorja e programit përcakton qartë dhe në mënyrë të detajuar objektivat dhe rezultatet e të nxënit, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë, planin mësimor, kriteret dhe kuotat e pranimit, programet lëndore, format e vlerësimit, fushat e kërkimit dhe rregullat e diplomimit. (Ref. 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze)			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Ndarja dhe organizimi i lëndëve është kryer në përputhje me përcaktimet e shtojcës 1 të VKM nr.879, datë 18.12.2019. (Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës). Elementët mësimorë përfshijnë respektivisht; Lëndët bazë në masën 18.9% për profilin Gjuhë Angleze, 16.7% për profilin Përkthim-Interpretim, 16.7% për profilin Studime Britanike dhe Amerikane. Lëndët karakterizuese, të cilat mbulojnë 55.6% në profilin Gjuhë Angleze, 16.7% në Përkthim-Interpretim, 16.7 % në Studime Britanike dhe Amerikane. Lëndët ndërdisiplinore përlllogariten me 11.1% në Gjuhë-Angleze, 8.9% Përkthim-Interpretim dhe me po të njëjtën përqindje në Studime Britanike dhe Amerikane. Lëndët plotësuese zenë 11.1% në të tre profilet e programit të studimit ndërsa detyrimet përmbyllëse përlllogariten në mënyrë të barabartë me 3.3% për të tre profilet. (Ref 2.5 Aneks RVB Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese;1.12 Aneks RVB Tabela 10 Plani mësimor i programit të studimit; 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Net përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Dokumentacioni i përfshirë në DVV përcakton se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, i cili ka në strukturën e vet organizative 6 njësi bazë (departamente). Departamenti i Gjuhës Angleze përmbush detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 dhe të gjitha parashikimet e përcaktuara në nenin 45 të Statutit të Universitetit të Tiranës. (Ref 1.2 Statuti i Universitetit të

	<p>Tiranës) Kjo njësi bazë ka në përbërjen e saj 47 anëtarë, personel akademik me kohë të plotë dhe 42 pedagogë me kohë të pjesshme, të rekrutuar për të përmbushur nevojat e këtij departamenti me staf akademik. Universiteti i Tiranës, është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 84, datë 27/10/2018.</p>																					
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Përgjegjësi i departamentit organizon, koordinon dhe siguron mirëfunksionimin e veprimtarisë brenda departamentit duke përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara sipas ligjit nr 80/2015. Përgjegjësitë e tij parashikohen në nenin 23 të Rregullores së UT-së. Përgjegjësi i departamentit ngarkohet me detyra që lidhen me organizimin e planit mësimor dhe rregullores së programit, menaxhimin e materialit mësimor dhe infrastrukturës mbështetëse, mbikqyrjen e procesit mësimor, organizimin e veprimtarive shkencore dhe koordinimin me njësitë e tjera të FGJH-së. (Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës)</p>																					
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të paraqitur pranë GVJ, organizimi dhe struktura akademike e FGJH-së dhe DGJA-së mbështetet në parashikimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015, neni 23/25 dhe udhëzimin nr.27, datë 29.12.2017 të MASR si dhe përcaktimeve të Statutit dhe Rregullores së UT-së. (Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës).FGJH-ja organizohet në 6 departamente dhe ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë. Struktura akademike përbëhet nga dekanati (dekani, katër zëvendësdekanë dhe përgjegjësat e departamenteve). FGJH ka administrator dhe struktura mbështetëse për përmbushjen e detyrave administrative. (Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës)</p>																					
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në vitin akademik aktual 2021-2022, ka 216 staf akademik gjithsej, ku 132 janë pedagogë me kohë të plotë, dhe 84 pedagogë me kohë të pjesshme.</p>																					
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<table border="1" data-bbox="577 1509 1385 1930"> <thead> <tr> <th>Fakulteti i Gjuhëve të Huaja</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>15</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Prof. As. Dr.</td> <td>22</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Dr. / PhD.</td> <td>81</td> <td>11</td> </tr> <tr> <td>MSc.</td> <td>14</td> <td>66</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>132</td> <td>84</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td colspan="2">216</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ konstaton se Departamenti i Anglishtes në vitin aktual</p>	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	PAE	PAK	Prof. Dr.	15	3	Prof. As. Dr.	22	4	Dr. / PhD.	81	11	MSc.	14	66	Në total	132	84	Totali	216	
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	PAE	PAK																				
Prof. Dr.	15	3																				
Prof. As. Dr.	22	4																				
Dr. / PhD.	81	11																				
MSc.	14	66																				
Në total	132	84																				
Totali	216																					

2021-2022, ka 89 personel akademik gjithsej, 47 pedagogë me kohë të plotë dhe 42 pedagogë me kohë të pjesëshme.

Departamenti i Anglishtes	PAE	PAK
Prof. Dr.	4	3
Prof. As. Dr.	3	2
Dr. / PhD.	35	8
MSc.	5	29
Në total	47	42
Totali	89	

Struktura akademike e Departamentit të Gjuhës Angleze përbëhet nga përgjegjësi i departamentit dhe shtatë grupe mësimore/kërkimore shkencore. (Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës; 2.6 Aneks RVB Ngarkesa e stafit akademik të programit të studimit); (Ref. 1 ANEKS RVB TABELAT.pdf)

Në dokumentacionin e përfshirë në DVB, përcaktohet qartë se grupet mësimore, kërkimore-shkencore përbëhen nga personel akademik me kohë të plotë, konkretisht grupi i gjuhësisë teorike (7 anëtarë), i gjuhësisë së zbatuar (7 anëtarë), i studimeve kulturore britanike (6 anëtarë), i studimeve kulturore amerikane (5 anëtarë), i didaktikës dhe metodikës (8 anëtarë), i përkthimit dhe interpretimit (8 anëtarë) dhe i komunikimit ndërkulturor (6 anëtarë).

(Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës; 2.6 Aneks RVB Ngarkesa e stafit akademik të programit të studimit)


Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e	Njësia përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" siguron dhe ofron informacionim e nevojshëm në lidhje me programin e studimit, planin mësimor, rregulloren e programit sikurse dhe jep të dhëna në

<p>nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>mënyrë të detajuar mbi objektivat, përshkrimin e programit, elementët përbërës të tij, strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat mbështetëse, kriteret e pranimit, stafin akademik, programin lëndor, mënyrat e vlerësimit dhe diplomën. (Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës)</p> <p>Për studentët e vitit të tretë të programit të studimit ofrohen module të formimit specifik, në përmbajtje të së cilëve përfshihen lëndë karakterizuese në fushën e mësimdhënies së gjuhës së huaj, përkthimit dhe studimeve britanike dhe amerikane. (Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës; 2.5 Aneks RVB Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese; 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze)</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Plani mësimor dhe rregullorja e programit të studimit strukturon dhe detajon organizimin e programit mësimor në lëndë, module, aktivitete formuese dhe praktike në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi. (Ref 1.12 Aneks RVB Tabela 10 Plani mësimor i programit të studimit; 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze)</p> <p>Veprimtaritë formuese ndahen në lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe klasifikohen sipas kategorive;</p> <p><u>Për profilin gjuhë angleze:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A, Lëndë bazë: 34 kredite (6 lëndë të detyrueshme); - Kategoria B, Lëndët karakterizuese 100 kredite (23 lëndë të detyrueshme); - Kategoria C, Lëndët ndërdisiplinore: 20 kredite (5 lëndë me përzgjedhje); - Kategoria D, Lëndët plotësuese, 20 kredite (5 lëndë me përzgjedhje); <p><u>Për profilet Përkthim-Interpretim dhe Studime Britanike dhe Amerikane:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A, Lëndë bazë: 30 kredite (5 lëndë të detyrueshme); - Kategoria B, Lëndët karakterizuese 108 kredite (24 lëndë të detyrueshme), Përkthim Interpretim; - Kategoria B, Lëndët karakterizuese 108 kredite (25 lëndë të detyrueshme), Studime Britanike dhe Amerikane; - Kategoria C, Lëndët ndërdisiplinore: 16 kredite (4 lëndë me përzgjedhje) te dy profilet;




	<p>- Kategoria D, Lëndët plotësuese, 20 kredite (5 lëndë me përzgjedhje) te dy profilet:</p> <p>Ref 2.5 Aneks RVB Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese;1.12 Aneks RVB Tabela 10 Plani mësimor i programit të studimit;2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës)</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët dhe modulet e programit të ciklit të parë Bachelor vlerësohen me kredite ECTS, në përputhje me ligjin nr. 80/2015, VKM nr.41, datë 24.01.2018 dhe Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve. Kohëzgjatja e programit të ciklit të parë është tre vite akademike, të ndara në 6 semestra, me nga 15 javë mësimore secila. Kreditet e siguruar përgjatë këtij cikli janë 180, të shpërndarë në mënyrë të barabartë, përkatësisht 60 kredite për vit.</p> <p>(Ref 1.12 Aneks RVB Tabela 10 Plani mësimor i programit të studimit;1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze; 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës)</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ konstaton se organizimi i lëndëve në semestra sikurse dhe ngarkesa mësimore në auditor dhe jashtë tij (puna individuale e studentit) përcaktohet qartë në planin mësimor të programit të studimit. Programet lëndore (syllabus-et) përfshijnë në përmbajtjen e tyre elementë specifike të lidhur me numrin e leksioneve/seminareve, detyrave të kursit, projekteve, eseve dhe provimeve. Në varësi të natyrës dhe përmbajtjes së lëndës përcaktohen edhe rregullat e frekuentimit, sistemi dhe mënyra e vlerësimit dhe forma e provimit. Studentët informohen mbi strukturën dhe brendinë e planeve mësimore, të cilat afishohen edhe në mjediset e fakultetit. Ngarkesa mësimore javore është 20-25 orë dhe studentët informohen për të përmes faqes zyrtare të fakultetit ose këndit të njoftimeve. Puna individuale e studentit jashtë auditorit (600-700 orë) përllogaritet në varësi të numrit të krediteve për vit akademik dhe vlerësohet në total me 1200-1500 orë mësimore në vit. (Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës)</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacioni të paraqitur në dosjen e GVB, rezulton se kriteret dhe kuotat e pranimit përcaktohen në rregulloren e programit të studimit dhe përshtaten me natyrën e programit të studimit, hapësirat fizike të mjediseve dhe kapacitetet e stafit akademik dhe atij mbështetës. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë</p>




	<p>Angleze)</p> <p>Dekanati pranon propozimet dhe kriteret e përcaktuara nga njësia bazë. Kuotat dhe kriteret e miratuara nga Senati Akademik bëhen publike. Rregullorja e programit të studimit përkatësisht në nenin 11 të saj, përcakton kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur për transferimin e studimeve.</p> <p>(Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës;1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze)</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet lëndore miratohen nga përgjegjësi i departamentit përpara fillimit të vitit akademik. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze) Syllabus-et përmbushin objektivat e programit të studimit, bazohen në planin mësimor dhe hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse në fuqi dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. (Ref. 2.4 VKM nr. 879, datë 18.12.2019) Programet lëndore depozitohen pranë sekretarive përkatëse dhe publikohen në faqen zyrtare. Studentët informohen për përmbajtjen e tyre përpara fillimit të vitit akademik.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstatoi se programet lëndore përditësohen përpara fillimit të çdo viti akademik. Përmbajtja e tyre, sikurse dhe plani mësimor rishikohet dhe përmirësohet në mënyrë periodike. Ndryshimi dhe përditësimi vjen si nevojë për përshtatje ndaj ndryshimeve të vazhdueshme të tregut të punës ose dinamikave të brendshme. Ndryshimet e propozuara i kalojnë për miratim Senatit Akademik dhe i përcillen për dijeni MASR.</p> <p>(Ref. 2.11 Aneks RVB Ndryshimet në planin mësimor krahasuar me programet e licensuara; 2.12 Shkresë nr. 56 Formalizimi i planeve) mësimore të departamentit të gjuhës angleze)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.4


Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në

përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Dokumentacioni plotësues i përfshirë në DVV qartëson se ngarkesa mësimore e programeve të studimit të ciklit të parë parashikohet në ligjin nr.80/2015, nenin 73, pika 3 dhe në zbatim të tij përcaktohet kohëzgjatja (tre vite akademike) dhe numri i krediteve (180). Me një shpërndarje të barabartë, përgjatë çdo viti akademik sigurohen 60 kredite dhe ngarkesa mësimore vjetore përlogaritet në 1200-1500 orë të realizuara në auditor, në formën e leksioneve dhe seminareve dhe 600-700 orë në vit përgatitje individuale e pavarur e studentit. Ngarkesa e lëndëve me zgjedhje dhe detyrimet për frekuentimin e tyre përcaktohet gjithashtu në planin mësimor. Struktura e vitit akademik shpallet nga dekanati dhe përshtatet çdo vit me specifikat dhe përcaktimet ligjore të parashikuara. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze; 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës)</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Mbështetur në të njëjtat burime, rezulton se përmbajtja e veprimtarive mësimore i ofron studentëve dije të thelluara dhe mundësi për formim shkencor në fushën e studimeve gjuhësore, letrare, kulturore si dhe formim profesional në mësimdhënie, përkthim dhe komunikim. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze)</p> <p>Zhvillimi i procesit mësimor përmes leksioneve, seminareve, diskutimeve, kontrollit të vazhdueshëm të dijeve nxit tek studentët të nxënë të mënyrë kritike dhe krijuese, aftësitë komunikuese dhe thellon njohuritë e fituara në planin teorik duke synuar përshtatjen sa më të plotë të këtyre njohurive në nivel praktik dhe profesional. Rëndësi e veçantë i kushtohet punës individuale të studentëve jashtë auditorit duke synuar praktikimin e gjuhës së huaj dhe nxitur autonominë e studentit në procesin e mësimnxënies. Në përmbushje të kërkesave të mësipërme dhe si pjesë e vlerësimit studentëve u kërkohet që të përgatisin detyra kursi, ese dhe prezantime. (Ref. 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze; 2.5 Aneks RVB Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese)</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se shpërndarja e ngarkesës mësimore gjatë gjithë ciklit të studimeve synon përmbushjen e rezultateve të të nxënit dhe mundëson pajisjen e studentëve me kompetencat dhe shprehitë bazë. Raporti teori-praktikë, shpeshherë reflektohet me një numër të shtuar të orëve të seminarit, zgjedhje e diktuar nga natyra e lëndës apo</p>




<p>rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>nevoja për zhvillimin e veprimtarive praktike gjatë procesit të mësimdhënies. (Ref 2.5 Aneks RVB Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese)</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ konstaton se struktura e programit dhe përmbajtja e programeve lëndore sigurojnë rezultate të të nxënit në përputhje me dhe të krahasueshme me standardet ndërkombëtare për aftësi, njohuri dhe kompetenca. Struktura e programit bachelor përafrohet me programe të ngjashme ndërkombëtare, gjë që krijon mundësi për shkëmbim përvojash të stafit akademik dhe të studentëve, mundësuar nga marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara brenda programit Erasmus+. Gjatë viteve 2018-2021, 18 pedagogë dhe 15 studentë kanë përfitur nga projektet ndërkombëtare. Gjatë takimit të GVJ me personelin akademik, pedagogët vlerësuan angazhimin e njësisë kryesore dhe asaj bazë për krijimin e mundësive të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në projekte.</p> <p>Bazuar tek plani mësimor i shqyrtuar tek dokumentacioni shoqërues (<i>Aneks RVB, Tabela 10</i>), rezulton se 5220 orët e zhvilluara në auditor ndahen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1290 orë leksione në auditor; - 3930 orë seminare në auditor; <p>(Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës; 1.12 Aneks RVB Tabela 10 Plani mësimor i programit të studimit 2.5 Aneks RVB Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese; 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze)</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar përcakton se shpërndarja e lëndëve brenda kurrikulës synon arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Ndarja e këtyre veprimtarive parashikohet në shtojcën nr. 2 të VKM nr. 41, datë 24.01.2018, ku përcaktohet qartë se përqindjen më të madhe duhet ta zenë lëndët karakterizuese. Përqindja e krediteve dhe ndarja e ngarkesës për secilën lëndë ndihmon arritjen sa më të plotë të objektivave, lehtëson procesin e lëvizjes dhe transferimit të studimeve sikurse siguron përshtatjen sa më të gjerë në tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe</p>	<p>Rishikimi dhe përditësimi i programeve lëndore lind nga nevoja për përshtatje me politikat arsimore në vend dhe për të përmbushur kërkesat dhe nevojat gjithmonë e në rritje të studentëve. Struktura e hartimit të programit lëndor përfshin elementët e detyrueshëm të përcaktuar në shtojcën 2 të VKM</p>

<p>ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>nr. 41, datë 24.10.2018. (Ref 2.17 Aneks RVB Modeli i programeve lëndore, elementet sipas VKM 41,2018, Tabela 14)</p> <p>GVJ konstatoi se një pjesë e madhe e literaturës së rekomanduar për studentët nuk është përditësuar me botime të 5 viteve të fundit. Gjithashtu studentëve nuk u rekomandohen burimet e bibliotekave online që ofrohen nga institucioni, të cilat mund t'i shfrytëzojnë.</p> <p><i>GVJ rekomandon përditësimin e literaturës me botime të 5 viteve të fundit në funksion të programit të studimit.</i></p> <p><i>(Ref.Sylabuset e lëndëve të programit të studimit, Pikat 183-222).</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton se shpërndarja dhe përmbajtja e lëndëve synon të përmbushë objektivat e parashikuara të programit të studimit. Përveç dijeve dhe njohurive të marra për fusha të caktuara studimi, studentët pajisen me aftësi të veçanta të thelluara në përshtatje me tregun e punës. Programi kombinon teorinë me praktikën duke nxitur tek studentët të menduarit krijues dhe kritik. (Ref. 1.3 Rregullore e Departamentit të Gjuhës Angleze; 2.5 Aneks RVB Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese; 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze).</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se DVV përmban informacion të detajuar lidhur me përmbajtjen e programeve të studimit. Dijet dhe njohuritë e fituara gjatë studimeve në ciklin e parë u japin studentëve mundësinë për vazhdimin e ciklit të dytë në programet Master Profesional dhe Master i Shkencave. Formimi profesional i përfutur në disiplina si përkthimi, interpretimi dhe mësimdhënia e gjuhëve të huaja i orienton studentët drejt studimeve më të thelluara gjatë ciklit të studimeve master. (Ref 1.3 Rregullore e Departamentit të Gjuhës Angleze; 2.5 Aneks RVB Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese) DGJA ofron një Master Profesional në "Përkthim" me profil "Përkthyes" dhe tre programe "Master i Shkencave" me profil "Mësues i Gjuhës Angleze për Arsimin e mesëm të lartë", "Përkthim teknik-letrar" dhe "Gjuhë dhe Komunikim ndërkulturor dhe turistik". (Ref 1.3 Rregullore e Departamentit të Gjuhës Angleze)</p> <p>Aftësitë dhe njohuritë që studentët përfitojnë gjatë formimit të tyre janë në përshtatje të plotë me zhvillimet në vend dhe kërkesat e tregut të punës. Konteksti i zhvillimit të vendit dhe politikat arsimore favorizojnë punësimin e studentëve si</p>




	përkthyes, interpret, mësues i gjuhës angleze etj. (Ref 1.10 Studimi i tregut të punës për studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Dhjetor, 2021)			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Zhvillimet e kohëve të fundit dhe kërkesat e tregut të punës nxitin nevojën për përditësim të përmbajtjes të programit. Veprimtaritë e organizuara në departament dhe fakultet, konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj, krijojnë ura lidhjeje dhe komunikimi me partnerë që vijnë nga tregu i punës dhe sjellin informacione mbi nevojat dhe kërkesat e praktikës. Shkëmbimet e përvojës me anëtarët e rrjetit Alumni, mundësuar përmes veprimtarive të realizuar nga Zyra për Këshillim dhe Karriere dhe Zyra e Burimeve Njerëzore, shërbejnë si një tjetër mjet informimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Bazuar tek dokumentacioni plotësues i paraqitur nga GVB, personeli akademik i angazhuar pranë departamentit të gjuhës angleze përmbush detyrimet dhe kërkesat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Stafi akademik përfshin kategoritë “profesor”, “lektor” dhe “asistent-lektor”, nga të cilët më shumë se gjysma e personelit i përkasin kategorisë “lektor” Bazuar në tabelat 6.1 – 6.3 të RVB është:
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 74 pedagogë nga të cilët 46 PAE dhe 28 PAK (62 % /38 %) 2. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 81 pedagogë nga të cilët 48 PAE dhe 33 PAK (60 % /40 %) 3. Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 95 pedagogë nga të cilët 50 PAE dhe 45 PAK (52 % / 48 %): 4. Për vitin akademik 2018 - 2019 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 105 pedagogë nga të cilët 50 PAE dhe 55




PAK (47 % / 53 %)

Referuar dokumentacionit të paraqitur dhe të dhënave të shqyrtua, GVJ konstaton se pavarësisht faktit që numri personelit akademik me kohë të plotë i angazhuar këtë program studimi nuk e kalon masën 70%, ky staf mbulon ngarkesën mësimore në përputhje me udhëzimet e VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. Pasi analizuam informacionin e dhënë në tabelat 12.1-12.3 të RVB, për ngarkesën mësimore javore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë:

- 2019-2020 90 %(PAE) / 10%(PAK);
- 2020-2021 87.5 %(PAE) / 12.5 %(PAK);
- 2021-2022 84.7 %(PAE) / 15.3 %(PAK);

Ndërsa kualifikimi sipas viteve është si më poshtë:

Tituj/grada	2021- 2022		2020 - 2021		2019 - 2020	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	6	1	7	0	7	1
Prof.As.Dr	3	2	3	2	3	3
Dr/PhD	33	9	33	10	34	6
Msc	4	16	5	21	6	35
Në total	46	28	48	33	50	45

(Ref 2.18 Aneks RVB Cilësia e stafit të mësimdhënies për programin e studimit)

Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Pasi shqyrtoi informacionin e dhënë nga institucioni, GVJ konstatoi se aktiviteti kërkimor i stafit akademik orientohet sipas fushave përkatëse dhe nivelin e zbatimit në lëndët që secili pedagog mbulon. Personeli akademik organizon veprimtari kërkimore-shkencore, merr pjesë në to dhe realizon botime në përputhje me fushat e veçanta të studimit. Nga të dhënat e siguruar përmes dokumentacionit të ofruar nga GVB, veprimtaria kërkimore-shkencore e personelit akademik të njësisë bazë për vitet 2019-2022 rezulton e tillë; Numri i botimeve nga personeli efektiv i DGjA- 26; Numri i projekteve kërkimore të fituara në shkallë departamenti/fakulteti -7; Numri i projekteve të zbatuara nga departamenti/fakulteti-6; Numri i veprimtarive shkencore të organizuara nga departamenti-1.

Në fillim të vitit akademik, personeli akademik bën parashikimin e ngarkesës vjetore në auditor dhe jashtë tij dhe përpilon formularin e organizimit të kohës vjetore të punës.


	<p>Stafi akademik përditëson në mënyrë të vazhdueshme CV akademike, programet lëndore dhe leksionet, literaturën dhe materialet ia ve në dispozicion studentit.</p> <p>(Ref 2.18 Aneks RVB Cilësia e stafit të mësimdhënies pr programin e studimit; 2.19 Raport mbi veprimtarinë kërkimore shkencore të DGJA për periudhën 1.10.2019-30.09.2020; Ref 2.20 Raport mbi veprimtarinë kërkimore shkencore të DGJA për periudhën 1.10.2020-30.09.2021)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Pasi shqyrtoi dokumentacionin përcjellës, GVJ konstatoi se studentët e programit Bachelor në “Gjuhë Angleze” kanë mundësi të angazhohen në veprimtari të organizuara nga FGJH-ja përmes mobiliteteve, botimeve, kurseve të përbashkëta për studentët, shkëmbimit të përvojave në mësimdhënie, ndarjes së informacionit shkencor etj. Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të Universitetit të Tiranës, studentë të departamentit të gjuhës angleze, kanë kryer mobilitete. Gjatë vitit akademik 2020-2021, 19 studentë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja kanë përfituar nga programi i mobilitetit Erasmus+. Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët, këta të fundit rikonfirmuan angazhimin e tyre në projektet e realizuara.</p> <p>(Ref 2.12 Shkresë nr. 56 Formalizimi i planeve mësimore të departamentit të gjuhës angleze; 2.16 Shkresë e FGJH-së Përcillen emrat e studentëve që kanë kryer mobilitete Erasmus gjatë vitit 2020-2022)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe kreu vizitat në institucion, GVJ konstatoi se FGJH-ja siguron infrastrukturën teknike të përshtatshme për zhvillimin e seminareve dhe laboratoreve. Kjo njësi ka vënë në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor; 33 salla seminaresh, 5 salla leksionesh, 1 sallë AUF, 4 laboratorë, 2 salla biblioteke. Sallat e leksioneve dhe pjesërisht e seminareve janë të pajisura me projektor. Në sallat e leksioneve janë instaluar tavolinat smart, mikrofova dhe ekran interaktiv. Në dispozicion të pedagogëve janë vendosur dy monitorë me lidhje internet broadband, një priter /fotokopje/skaner. Fakulteti ka mbulim me rrjetin Wi-Fi. (Ref 2.22 Inventari i auditorëve; 3.7 Aneks RVB Mjediset e fakultetit, njërive bazë, tabela 16)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
---------------------------------	------------	-------------------	-------------------	-------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al





standardeve të fushës II	përfundohet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ konstaton nga vlerësimi i dokumentacionit shoqërues dhe nga vizita në institucion se FGjH dhe DGjA kanë hartuar udhëzues në nivel institucional për përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve dhe lëndëve. SZhFGjH parashikon zbatimin e modeleve inovative të mësimimit miks përmes metodologjive të mësimdhënies të bazuar në qasjen e përzier të mësuarit dhe përmirësimit të aftësive të tyre digjitale.</p> <p>GVJ konstaton se mbështetur në SZhFGjH, për këtë program studimi janë realizuar objektivat lidhur me mësimdhënien e orientuar drejt kërkimit shkencor për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Konkretisht, GVJ evidentoi nga vizita në institucion se janë realizuar: 1.vendosja e tabelave interaktive në auditore; 2.janë ndërtuar laboratorë për kërkim shkencor; 3. salla leksioni që funksionojnë me teknologji të avancuar të tilla si tavolinat digjitale `smart tables`, sistem audio (AUF) dhe kabina përkthimi me dy poste. Stafi akademik është udhëzuar për përdorimin e tyre nëpërmjet trajnimeve për dixhitalizimin (Ref. 1.5: SZhFGjH, 2021-2024, Objektivi 8, 13, Pika 13.7/13.9).</p> <p>GVJ konstaton se aspektet e mësimdhënies që lidhen me digjitalizimin dhe teknologjinë janë reflektuar përgjatë periudhës së pandemisë Covid 19, ku UT ka dalur me Rregulloren për të zhvilluar një process mësimor normal duke mbështetur pedagogët dhe studentët me ofrimin e platformave të komunikimit dhe teknologjisë së informacionit dhe duke i trajnuar ata për këto forma të mësimdhënies. (Ref. 3.3 Udhëzues i UT për përdorimin e sistemit të mësimimit në distancë. Ref 3.9. Rregullore e brendshme e UT për mbrojtjen nga infeksionin i shkaktuar nga virusi Covid 19).</p>




<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Duke iu referuar RVB dhe dokumentacionit shoqërues të tij GVJ konstaton se UT ka hartuar Rregullore për sigurimin e Cilësisë në nivel universiteti (Ref 1.20 Rregullore për sigurimin e Cilësisë, Neni 6 dhe 7), cila përcakton parimet për menaxhimin e cilësisë sipas sistemit të vlerësimit ISO-s 9001-2015 dhe i përmbahet standarteve për sigurimin e brendshëm të Cilësisë duke respektuar Standartet Evropiane të miratuara nga Konferenca Ministeriale në Maj 2015 dhe standartet kombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e Lartë të miratuar nga Këshilli i ministrave, 2018. GVJ konstaton se FGJH, si njësi kryesore, mbështetur në këto standarte dhe parime, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Grupet e vlerësimit të brendshëm për cdo njësi bazë, si struktura që zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të mësimdhënies, personelit akademik, si edhe programit të studimit. (Ref. 3.12.1 Përgjigje shkresës `Ngritja e GVB-së`; Ref.3.11 Urdhër i Brendshëm për ngritjen e NJSBC).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se FGJH ka në përbërje të organigramës së tij Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, (Ref. Struktura Organizative e FGJH: unitir.edu.al/struktura-organizative-e-fakultetit-te-gjuheve-te-huaja/ www.fgjh.edu.al), e cila ashtu si edhe DGJA nëpërmjet drejtuesit kryesor të saj organizon takime formale dhe informale të vazhdueshme me studentët për mënyrën e zhvillimit të programit mësimor. Nga vizita në institucion u konstatua se studentët janë përfshirë si pjesë integrale e procesit të monitorimit të cilësisë, ku evidentohet se dy studentë janë anëtarë në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. (Ref.3.11 Urdhër i Brendshëm për ngritjen e NJSBC). NJSBC harton instrumentin, i cili përdoret për opinionin e studentëve në lidhje me programin e studimit dhe pas analizës së të dhënave harton raportin e vlerësimit të studentëve të diplomuar. (Ref 3.4 Model i pyetësorit të studentëve. Ref 3.5 Raporti i vlerësimit të studentëve të diplomuar).</p> <p>GVJ, po ashtu, konstatoi nga vizita në institucion se studentët kanë mundësinë e paraqitjes së ankimimeve për çështjen e notës ose ankesa të tjera që lidhen me procesin mësimor tek Përgjegjësi i DGJA, mbështetur në Rregulloren e UT-së dhe Rregulloren e programit të studimit. (Ref.2.1: Rregullore e UT-së, Neni 50-51. Ref. 1.6 Rregullore e programit të studimit neni 14, Ref 1.20.1 Manuali i vlerësimit të cilësisë. Ref. 1.20.2: Paketa e instrumentave të cilësisë).</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues në DVV dhe vizitës në</p>




<p>përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>institucion GVJ konstaton se FGjH në organigramën e tij ka ngritur Degën e Cilësisë, Vlerësimit dhe Kurrikulës, si strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ (Ref. Struktura Organizative e FGJH: unitir.edu.al/struktura-organizative-e-fakultetit-te-gjuheve-te-huaja www.fgjh.edu.al). Po ashtu, GVJ vlerëson se është ngritur me urdhër të brendshëm Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) si strukturë përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, e cila në bashkëpunim me strukturën Degën e Cilësisë, Vlerësimit dhe Kurrikulës harton dhe publikon raportet e vlerësimit tek Dekani i FGjH, i cili në vijim të procesit të publikimit i bën të ditura përgjegjësi i njësisë bazë (DGjA). (Ref. 3.5 Raporti i vlerësimit të studentëve të diplomuar, viti akademik 2020-2021.; Ref.6.11 Raport Vlerësimi nga personeli akademik; Ref. Dok Shtesë. Pika 8. Shkresë përcjellja e Raportit permbledhes te studenteve te diplomuar dhjetor 2021.pdf.; Ref. Pika 9. Shkresë Përcjellja e Raportit Vjetor 2020-2021).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se FGjH mbështetur në Rregulloren për sigurimin e cilësisë, (Ref 1.20 Rregullore për sigurimin e cilesisë, neni 12 pika 4 dhe 5) nëpërmjet strukturës NJSBC e ngritur në nivel fakulteti, përpunon dhe publikon rezultatet e cilësisë si një formë për të promovuar praktikat më të mira të mësimdhënies, si edhe për të nxitur personelin akademik për përmirësim mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. GVJ konstaton nga vizita në institucion (takimi me pedagogët) se stafi akademik i programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze i mer rezultatet e performancës së tij në formë individuale nëpërmjet komunikimit elektronik, (Ref. 6.11 Raporti Vlerësimi nga personeli akademik.pdf).</p> <p>GVJ konstaton nga vizita në institucion (takimi me përgjegjësin e departamentit dhe përfaqësues të Zyrës së Cilësisë) se rezultatet e raporteve të përpiluara nga strukturat e posaçme të monitorimit të cilësisë, u përcillen Dekanit dhe përgjegjësit të DGjA. Gjetjet nga raportet bëhen publike dhe diskutohen në department, (Ref. 3.5, Raport vleresimi i studenteve te diplomuar, viti akademik 2021-2022.pdf; Ref. Dokumentacion shtesë, Pika 8.Shkrese percjellja e Raportit permbledhes te studenteve te diplomuar dhjetor 2021.pdf; Pika 9 Shkrese percjellja e Raportit Vjetor 20-21, cilesia.pdf).</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>




standardit	plotësisht	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues në DVV, u konstatua nga GVJ se hartimi i planit mësimor për Programin Bachelor në "Gjuhë Angleze" është realizuar në mbështetje të Statutit të UT-së (Ref.2.1 Statuti i UT-së, Neni 89 Programet e studimit të Ciklit të Parë). Ref. 1.6 Rregullore e Programit të studimit Bachelor në gjuhë angleze, Neni 5, 6 dhe 12 Ref.1.3 Rregullore e Departamentit të gjuhës angleze, Neni 18).</p> <p>GVJ evidenton se veprimtaria mësimore parashikohet në Rregulloren e programit të studimit, ku përcaktohet ndarja e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese dhe në semestra, ndarja e orëve mësimore në leksione, seminarë në auditor dhe orët e studimit individual, së bashku me numrin e krediteve për lëndët e ofruara në programin e studimit. (Ref. 2.5, Aneks RVB, Plani mesimor i ndare sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (2020-2023), (Tabela 9).pdf) GVJ konstaton nga dokumentacioni i paraqitur se plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze", ofruar me 180 kredite sipas sistemit (ECTS), me një shtrirje kohore normale 3 vite akademike, përmban këto elementë kryesorë të mësimdhënies, nxënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive: 1. takimet frontale, mësimi në auditor nëpërmjet orëve të leksioneve dhe seminarëve; 2. orët e studimit individual. (Ref.1.12 Aneks RVB, Tabela 10. Plani mësimor i programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqërues i RVB-së se personeli akademik krijon kushte për t'iu përshtatur dhe përgjigjur diversitetit dhe nevojave të studentëve me qëllim arritjen e objektivave të tyre akademike. Gjithashtu, evidentohet angazhimi i personelit akademik për të krijuar një mjedis të përshtatshëm dhe ndërveprues për kushte të barabarta midis studentëve duke ofruar forma dhe mundësi alternative të mësimnxënies si: krijimi i një klime pozitive diskutimi, puna në grup, organizimi i leksioneve me lektorë të ftuar, seminarë dhe shkolla verore. (Ref 1.3 Rregullore e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Departamentit të gjuhës angleze, neni 4, neni 12).</p> <p>GVJ konstaton se format alternative të mësimdhënies dhe nxënies janë praktikuar kryesisht gjatë periudhës së Pandemisë "Covid 19" për të siguruar një proces të rregullt mësimor, si klasat virtuale, diskutimi on-line, publikimet e informacionit dhe detyrave në rrjetet sociale etj. (Ref. 3.3 Udhëzues i UT për përdorimin e sistemit të mësimit në distancë). FGJH ka parashikuar në Strategjinë e zhvillimit të departamentit përditësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programeve mësimore dhe programeve lëndore me qasje të reja metodologjike dhe teknologjike. (Ref. 3.17 Strategjia për teknologjinë dhe informacionin në mësimdhënie e nxënie e FGJH, Dhjetor 2021).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, GVJ konstaton se FGJH është i angazhuar për të mbështetur personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike duke mundësuar shkëmbime të personelit në universitetet partnere perëndimore me qëllim përfundim të praktikave mësimore më të mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, nxënies dhe transmetimit të dijes. (Ref. 2.19/ Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore të Departamentit të Gjuhëve të huaja për periudhën Tetor 2019 – Shtator 2020. Ref. 2.20 Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore të Departamentit të Gjuhëve të huaja për periudhën Tetor 2020 – Shtator 2021).</p> <p>GVJ evidenton nga shqyrtimi i dokumentacionit se 31 anëtarë të personelit akademik të FGJH kanë qenë pjesëmarrës si partnerë në 5 Projekte ndërkombëtare, (Ref. 2.14 Aneks RVB: Tabela 20. Të dhënat për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të FGJH), nga të cilët, për Programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze për periudhën 2018-2021, janë (5) projekte ndërkombëtare me staf përfitues për mobilitetin (18) pedagogë dhe (2) projekte kombëtare me staf përfitues (7) pedagogë.</p> <p>(Ref. Dok.Shtesë, Pika 10. Të dhëna për mobilitetin staf dhe student për programin e Gjuhës Angleze).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ pasi mori në shqyrtim të dhënat për veprimtarinë kërkimore-shkencore, si edhe jetëshkrimet (CV-të) e personelit akademik të Programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" vlerëson se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi është në përputhje me kuadrin ligjor për mësimdhënien në Ciklin e Parë të</p>




<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Studimeve, është kompetent për shpjegimin e njohurive, si edhe përdor metoda inovatore të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit të këtij program studimi (Ref.2.21 CV-të e personelit akademik; Ref.3.6: Aneks RVB Tabela 12, Plani mësimor lidhur me stafin akademik përkatës).</p> <p>GVJ shprehet se personeli akademik ka vlerësuar dhe ka përmirësuar metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave akademike si pjesëmarrës partner në disa projekte dhe si lektorë në institucione partnere, (Ref. 2.14 Aneks RVB: Tabela 20, Të dhënat për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të FGJH).</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Referuar RVB-së, dokumentacionit shoqërues të tij dhe vizitës në institucion, GVJ evidenton se personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi për të krijuar një mjedis mësimor tërheqës dhe ndërveprues duke ofruar forma dhe mundësi alternative të mësimdhënies si: krijimi i një klime pozitive diskutimi, puna në grup, simulime, puna me projektet, prezantime (Ref 1.3 Rregullore Departamenti i gjuhës angleze, Neni 12).</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se këto forma alternative të mësimdhënies dhe mësimdhënies janë praktikuar edhe gjatë periudhës së Pandemisë Covid 19 për të siguruar një proces të rregullt mësimor. (Ref. 3.3 Udhëzues i UT-së për përdorimin e sistemit të mësimi në distancë).</p> <p>GVJ konstaton se FGJH angazhohet për zhvillimin dhe përfshirjen në programet e lëndëve format më të fundit të teknologjisë në ndihmë të mësimdhënies (sallat e pajisura me tabela dhe ekrane interaktive, laboratorë që përdorin teknologji të avancuar, tavolinat smart në sallat e leksionit, sistem video projektimi, kabina me dy poste për procesin e përkthimit simultan dhe konsektiv), duke u bazuar në prurjet më të fundit digjitale dhe të infrastrukturës logjistike me në qendër studentin. GVJ, po ashtu konstaton nga dokumentacioni i paraqitur në DVV se format dhe metodat e mësimdhënies në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzime dhe mbështetje nga personeli akademik i DGJA, (Ref. 3.17 Strategjia e Teknologjisë dhe Inovacionit në mësimdhënie e nxënie e FGJH, Dhjetor 2021).</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Shkalla e përmbushjes së Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>





standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X


Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga shqyrtimi i referencave së paraqitur në RVB dhe mbështetur në vizitën në institucion, GVJ konstaton lidhur me inventarizimin e hapësirave të dedikuara për procesin mësimor, se në mjediset e FGJH ndodhen: 1 Laborator Fonetike, Godina B; 1 Laborator i Kërkimit Shkencor Godina B; Qendra e Trajnimeve dhe Inovacionit, Godina B; 1 Zyrë e Cilësisë, Godina B; Salla Europa, Godina B; Salla "Artur Sula", Godina A; (Ref. 2.22 Inventari i auditorëve). GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqërues i RVB-së dhe nga vizita në institucion se hapësirat janë të mjaftueshme dhe cilësore sipas normativës ligjore së sipërfaqes së shfrytëzuar. Këto mjedise janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht nga personeli i shërbimeve. Po ashtu, GVJ konstaton nga dokumentacioni mbështetës dhe nga vizita në institucion se FGJH disponon: 33 salla seminari; 5 salla leksionesh, 1 sallë AUF; 4 laboratorë për lëndët; 2 laboratorë përkthimi; 2 salla biblioteke; 1 mjedis shërbimi për të tretë (Arshiva); GVJ konstaton nga informacioni i paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion se ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisuara me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, si psh: sistem audio i integruar, tavolina "smart", ekrane interaktive në sallat e leksionit, Laboratorin e Kërkimit Shkencor; Qendrën e Trajnimeve dhe Inovacionit, sistem video projektimi, ekran interaktiv për sallën multifunksionale. (Ref. 3.7 Aneks RVB.Tabela 16, Mjediset e Fakultetit/Njësive bazë).</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisuara me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e RVB-së dhe dokumentacionin shoqërues të tij GVJ konstaton se për efekt të konsolidimit të infrastrukturës IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor përgjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga virusi Covid 19, FGJH në përputhje me Udhëzuesin e UT për përdorimin e mësimin në distancë, duke filluar nga viti 2020 ka aplikuar platformën digjitale "Microsoft Teams for Education", e cila është përdorur gjerësisht nga personeli akademik dhe</p>




	<p>studentët, (Ref 3.3 Udhëzues UT për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë). Referuar RVB-së, kjo platformë, e cila është plotësisht funksionale, vazhdon të shërbejë si një mjedis virtual mësimor me qëllim shkëmbimin e informacionit, publikimin e materialit mësimor dhe detyrave të kursit, realizimin e diskutimeve dhe forumeve të ndryshme. Po ashtu, GVJ evidenton mbështetur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, se FGJ ka në organigramën e tij Degën e IT-së, e cila siguron mbarëvajtjen e sistemin të teknologjisë brenda FGJH për mirëmbajtjen e lidhjes së shërbimit të internetit wifi dhe fiks në mjediset e gođinave A dhe B të FGJH. Për efekt të komunikimit institucional dhe shkëmbimit të informacionit, stafi akademik/ndihmës akademik dhe studentët disponojnë adresa zyrtare (emër.mbiemër@unitir.edu.al) (Ref. Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin shoqërues në DVV, (Ref. Dokumentacioni shoqërues, Pikat 183-222 në Procedurën e vlerësimit të jashtëm, Programet lëndore/sylabuset), vëren se literatura bazë dhe ndihmëse në gjuhën angleze e vënë në dispozicion për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze", përcaktohet qartë nga titullari i lëndës dhe garanton marrjen e dijeve të nevojshme të parashikuara nga programi i studimit. Nga vizita në institucion GVJ u informua se në përpilimin e sylabuseve, pedagogët u referohen mënyrës që universitetet partnere (kryesisht Britanike) i ofrojnë këto lëndë, duke i ristrukturuar në formë që të jenë të vlefshme për mobilitetin e studentëve. Studentët e Programit Bachelor në "Gjuhë angleze", kanë në dispozicion bibliotekën online Jstore dhe Ulibrary të UT-së. (Ref. Biblioteka online faqja zyrtare elektronike e UT, www.unitir.edu.al https://unitir.edu.al/biblioteka-online/).</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>GVJ konstaton nga vizita në institucion se Biblioteka e FGJH ka një hapësirë të mjaftueshme me dy salla leximi, të cilat shërbejnë si kënd studimi. Burimet që ajo ofron janë në formë fizike me një fond prej 2332 titujsh në gjuhën angleze. Sallat sigurojnë kushte optimale për lexim, studim dhe veprimtari të tjera në mbështetje të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Bibliotekat kanë një fond të madh titujsh librash, artikujsh, studimesh në disa gjuhë të huaja. Roseta Stone është gjithashtu një platformë për mësimin e gjuhës së huaj, e cila ofrohet pa limit dhe pa pagesë. (Ref. Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli</p>	<p>GVJ pasi vizitoi faqen zyrtare elektronike zyrtare të UT-së me qëllim njohjen e burimeve elektronike të literaturës, duke iu referuar RVB-së dhe nga vizita në institucion, u njoh me tre</p>





<p>akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>burime kryesore elektronike të literaturës për programin gjuhë angleze: dy biblioteka on line: Jstor dhe U-library, të cilat të cilat bëhen të aksesueshme nga shërbimet IT (Llogaria personale Office 365 krijuar nga UT). Po ashtu, platforma Cobbis + u mundëson bibliotekave dhe përdoruesve qasje online për disa baza të dhënash. (Ref. Manuali aksesit të bibliotekës online i UT-së, (Ref. www.unitir.edu.al, www.jstor.org, https://unitir.edu.al/uploads/2019/11/Manual-p%C3%ABrdorimi-ulibrary.pdf)</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqërues i RVB dhe nga vizita në institucion se për efekt të realizimit të laboratorëve, diplomave dhe detyrave të kursit, FGJH ka ngritur në infrastrukturën e tij dy laboratorë përkthimi, një laborator fonetike dhe një laborator të kërkimit shkencor. (Ref. 3.7 Aneks RVB.Tabela 16, Mjediset e Fakultetit/Njësive bazë; Ref 1.12 Plani mësimor).</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se FGJH në përputhje me Udhëzuesin e UT për përdorimin e mësimin në distancë, duke filluar nga viti 2020 ka aplikuar platformën digjitale "Microsoft Teams for Education" për mësimin në distancë, e cila është përdorur gjerësisht nga personeli akademik dhe studentët, (Ref 3.3 Udhëzues UT për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë). Kjo platformë, e cila është plotësisht funksionale vazhdon të shërbejë si një mjedis "e-learning"</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>GVJ konstaton, mbështetur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, se FGJH ka në organigramën e tij zyrën e IT, e cila siguron sistemin e komunikimit nëpërmjet teknologjisë brenda FGJH. Për efekt të komunikimit të brendshëm institucional dhe shkëmbimit të informacionit, stafi akademik/ndihmës akademik dhe studentët disponojnë adresa zyrtare (emër.mbiemër@unitir.edu.al) me anë të të cilave marri informacion në hapësirën vetjake të dedikuar si psh: "Llogaria personale Office 365" krijuar nga UT. (pritet të evidentohet dhe nga takimi në institucion) Ref. www.unitir.edu.al, https://fgjh.edu.al/hapsira-studentore-sistemi-informatik/</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni i paraqitur në DVV se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" me profile në "Gjuhë Angleze", "Përkthim dhe Interpretim", "Studime Britanike dhe Amerikane" përmbyllet me provim përfundimtar të diplomimit (Ref. 1.6 Rregullorja e programit të studimit, neni 13)</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nu Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB-së konstatohet nga GVJ se UT ka ngritur struktura të posaçme në nivel institucioni (Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, KPSSC; Njësia e sigurimit të Cilësisë (NJSBC) e UT-së, dhe Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB). Këto struktura hartojnë dhe koordinojnë veprimatrinë e tyre për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. GVJ gjithashtu konstaton se FGJH në nivel njësisë kryesore ka ngritur Zyrën e Cilësisë, Vlerësimit dhe Kurrikulës dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e përbërë nga 5 anëtarë staf akademik dhe 2 studentë. (Ref 3.11 Urdhër i brendshëm për ngritjen e NJSBC-së). NJSBC, për mirëfunksionin e saj, mbështetet në "Rregulloren për sigurimin e cilësisë të institucionit, UT", miratuar nga Senati Akademik, dt.23.12.2020 (Ref. 1.20 Rregullorja për sigurimin e cilësisë, UT). NJSBC është përgjegjëse për përpilimin dhe analizimin e raporteve vjetore apo raporteve të tjera, të cilat shërbejnë si bazë për zyrën e Kërkimit Shkencor. Fusha e veprimtarisë dhe efekti i njësisë është mbi të gjithë organet drejtuese, strukturat akademike/ndihmës akademike/ njësitë bazë, personelin akademik/ndihmës akademik, administrativ dhe studentë. (Ref. 1.20 Neni 3 Rregullore e për sigurimin e cilësisë, UT).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin shoqërues në RVB, konstaton se Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe departamenti i gjuhës angleze janë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së ndërgjegjësimit të personelit akademik dhe studentëve për cilësinë që programi gjuhës angleze ofron. (Ref. 1.20 Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë UT). Për sigurimin e cilësisë është hartuar në nivel universiteti 'Manuali i cilësisë' dhe 'Paketa e instrumentave të Cilësisë', (Ref. 1.20.1 Manuali i cilësisë (UT)). Referuar RVB-së dhe vizitës në institucion, anëtarët e personelit akademik të DGJA njihen me raportet e anketimeve të studentëve të përgatitur nga NJSBC në mënyrë individuale nëpërmjet e-mailit. (Ref. 1.20</p>


	Rregullorja për Sigurimin e Cilësise UT, Neni 25, drejtuesi i njesisë bazë/ neni 26 drejtuesi i njesisë kryesore).
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Nga vlerësimi që iu krye dokumentacionit të paraqitur në DVV dhe nga vizita në institucion konstatohet se DGjA mbështet stafin akademik nëpërmjet trajnimeve të cilat organizohen nga FGJH dhe nëpërmjet mobilitetit të stafit në kuadër të projekteve ndërkombëtare siç është Projekti Re@WBC për të eksperimentuar dhe zhvilluar metoda të reja inovative të mësimdhënies (Ref. www.fgjh.edu.al</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>https://fgjh.edu.al/?s=teaching+methodology</p> <p>https://fgjh.edu.al/re-imagining-teaching-and-research-in-the-face-of-the-new-dynamics-reality/.</p> <p>Po ashtu trajnime zhvilluar në kuadër të përdorimit të platformave digjitale për mësimin në distancë, si edhe trajnime në kuadër të projekteve Erasmuss + (Ref 3.3 Udhëzues i UT për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë. Manuali përdorimit Microsoft teams for education; Ref. 2.14)</p> <p>GVJ pasi ka shqyrtuar burimet e informacionit të paraqitura në DVV dhe dokumentacionin shtesë vlerëson se kryesisht personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në formë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor duke numëruar (61) botime nga stafi akademik për programin e studimit në periudhën 2018-2021, (Ref. Dok. Shtesë, Nr.6 Numri i projekteve aktive në 3 vitet të fundit). Duke iu referuar RVB-Së, numri i aktiviteteve shkencore (konferenca) për periudhën (2018-2021) nga DGjA është (3), nga të cilat njëra është konferencë studentore. GVJ konstaton nga vizita në institucion se për efekt të kualifikimit të mëtejshëm të personelit akademik dhe ndihmës akademik, institucioni disponon Revistën e FGJH, e cila botohet 4 herë në vit dhe është në proces për njohjen shkencore nga organet kompetente.</p> <p>GVJ, duke iu referuar dokumentacionit shoqëruar vëren se, pavarësisht kualifikimit të vazhdueshëm në formë individuale të stafit akademik të Programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" për efektin e fitimit të gradave dhe titujve shkencorë, si dhe angazhimit të PAE në organizimet e brendshme shkencore të FGJH, një pjesë e stafit akademik është më tepër aktive dhe më e angazhuar në fushën kërkimore - shkencore. (Ref. 2.19/ Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore të Departamentit të Gjuhëve të huaja për periudhën Tetor 2019 – Shtator 2020. Ref.2.20 Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore të Departamentit të Gjuhëve të huaja</p>




për periudhën Tetor 2020 – Shtator 2021).				
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues të tij, GVJ konstaton se DGJA realizon trajnime për personelin akademik, të cilat ofrohen nga DGJA nëpërmjet zbatimit të projekteve, në të cilat departamenti është pjesëmarrës partner, si për shembull Projekti Re@WBC, nga i cili është realizuar trajnimi nga përfaqësues nga DGJA sipas modelit "train the trainer" për implementimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Po ashtu stafi akademik është trajnuar për përdorimin e teknologjive të reja në mësimdhënie. (Ref. https://fgjh.edu.al/?s=teaching+methodology https://fgjh.edu.al/re-imagining-teaching-and-research-in-the-face-of-the-new-dynamics-reality/) (www.fgjh.edu.al/cikli/i/trajnimeve/mbi/teknologjite/e/reja/ne/mesimdhenie)</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rregullator të UT-së dhe Departamentit të gjuhës angleze, GVJ vëren se në përmbajtjen e tyre janë parashikuar qartë detyrimet dhe përgjegjësitë e personelit akademik/ndihmës akademik, si dhe angazhimi i tyre për përmirësimin e mësimdhënies. Përgjegjshmëria e personelit akademik dhe ndihmës akademik reflektohet pas trajnimeve që ata marrin, nga takimet dhe diskutimet në mbledhjet e departamentit dhe të fakultetit, (Ref. 2.1 Rregullore UT, nenet 27-29. Ref 1.3 Rregullore e Departamentit të Gjuhës Angleze.pdf, nenet 10 /12).</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ konstaton se përgjithësisht personeli akademik përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies mbështetur në teknologjinë e informacionit sipas specifikave të temave të caktuara të profilit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze"(Ref. Dokumentacioni shoqërues, Pikat 183-222, Programet lëndore/sylabuset).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5



Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB-së konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregulloren e Programit të studimit në kuadrin e ndjekjes së veprimtarive mësimore, (Ref. 1.6 Rregullore e Programit të studimit. Neni 7. 12.13 Ndjekja e veprimtarive mësimore). RVJ konstaton nga dokumentacioni shoqërues dhe nga vizita në institucion se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përlllogaritja e vlerësimit për lëndën përkatëse bëhet nga titullari i lëndës dhe u komunikohet studentëve në fillim të vitit akademik/semestrit. (Ref. 1.6 Rregullore e Programit të studimit. Neni 13/13.6). Syllabuset përcaktojnë elementët e testimit dhe vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale kryesisht në përputhje me tabelën 15 të referuar në RVB. (Ref. 2.10 Dosja me Programet lëndore (syllabuset); Ref. 3.15 Aneks RVB format e kontrollit të njohurive tabela 15).</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe vizitës në institucion takimi me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. (Ref 1.6 Rregullore e Programit të studimit. Neni 13. 13.2/13.3./13.6) Në shqyrtimin që iu bë programeve të lëndëve vërehet se përgjithësisht testimi i njohurive dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma të ndryshme si: detyra kursi, projekte, prezantime, pjesëmarrja në diskutime. Çdo program lëndor parashikon provimin e ndërmjetëm dhe atë përfundimtar. (Ref. 2.10 Dosja me programet lëndore (syllabuset); Ref. 3.15 Aneks, RVB format e kontrollit të njohurive, Tabela 5)</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.6



Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Bazuar në informacion e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ vëren se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. Në programet e lëndëve është parashikuar forma e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm dhe vlerësimi. (Ref. 2.10 Dosja me Programet lëndore (syllabuset); Ref 1.6 rregullore e Programit të studimit-Neni 13. 13.2/ 13.3)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Mbështetur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues të tij, GVJ nuk konstaton forma elektronike të testimit dhe vlerësimit për programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, përveç kushteve të jashtëzakonshme si në situatën e zhvillimit të mësimin në distance, kur provimet në dy vitet e fundit u zhvilluan on-line nëpërmjet Paketës Office 365 (Forms); (Ref 3.3 Udhëzues i UT për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë).</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se sipas Rregullores së UT-së dhe Rregullores së programit të studimit, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku (2) anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit dhe miratohet nga përgjegjësi i DGJA (Ref 2.1 Rregullore e UT-së, Neni 46 dhe neni 48.)</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Referuar RVB-së, GVJ konstaton se testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim zhvillohet në mënyrë anonime, proces në të cilin është angazhuar sekretaria mësimore, e cila sekretion testin dhe e dekodifikon atë pas vlerësimit në mënyrë anonime nga komisioni i provimit. (Ref 2.1 Rregullore e UT-së, Neni 45-49; Ref 1.6 Rregullore e Programit të studimit.Neni 12/13).</p> <p>GVJ vëren se sipas rregullores së programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze dhe nga vizita në institucion, departamenti ngre komisione për mbikqyrjen e zhvillimit të procesit të provimeve dhe siguron infrastrukturën e duhur për këtë proces (Ref 1.6 Rregullore e Programit të studimit.Neni13. pika 13.8)</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente nga ana e pedagogëve atëherë kur vlerësohet e nevojshme dhe se para shpalljes dhe regjistrimit formal të notës të provimit përfundimtar të lëndës, pedagogët zhvillojnë takime sqaruese me studentët duke i referuar me</p>

<p>studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>komente vlerësimi për format e vlerësimit përfundimtar, me qëllim këshillimin mbi procesin e të nxënës dhe mundësinë për përmirësim në të ardhmen. (Ref 1.6 Rregullore e Programit të studimit. Ref. 2.1 Rregullore e UT-së).</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin shoqërues të RVB-së, GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit bachelor në Gjuhë Angleze parashikon që departamenti të ngrejë komisione për mbikqyrjen e zhvillimit të procesit të provimeve dhe siguron infrastrukturën e duhur për këtë proces. (Ref 1.6 Rregullore e Programit të studimit/Neni14.)</p> <p>Po ashtu, GVJ konstaton se Kodi i Etikës i UT përcakton si detyrim të studentëve moskopjimin dhe mashtrimin në procesin mësimor dhe provime, si edhe sanksionet që pasojnë këto detyrime. (Ref 3.16 Kodi i Etikës UT, Neni 5 pika f, Neni 7).</p> <p><i>GVJ rekomandon së është e nevojshme që edhe kuadri rregullator i brendshëm i FGJH të përfshijë nga ana formale rregulla të qarta mbi plagjiaturën, mënyrën e kontrollit të plagjiaturës dhe shmangjen e saj.</i></p> <p>(Ref. 2.1.1 Rregullore e brendshme e FGJH).</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Refuar informacionit të paraqitur në RVB, rezultatet e kontrollit të dijeve si provimi i ndërmjetëm dhe provimi përfundimtar u jepen zakonisht studentëve brenda dy javëve nga zhvillimi i tyre. GVJ nuk konstaton se kjo procedurë është parashikur në rregulloren e programit të studimit siç edhe citohet në RVB. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit, neni 13).</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin shoqërues dhe informacionin në RVB, konstatohet nga GVJ se Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze garanton të drejtën e studentit të ankohet për procedurën e zhvillimit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të DGJA, brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit, e cila në rast mos zgjidhjeje të ankesës pas shqyrtimit nga Përgjegjësi i Departamentit i paraqitet Dekanit për shqyrtim dhe vendimmarrje. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit, neni 14).</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ gjithashtu konstaton se në Rregulloren e UT-së parashikohet e drejta e studentit për ankimimin e vlerësimit të tij, ku si rregull studenti njofton me shkrim Përgjegjësin e Departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të vlerësimit me notë, i cili në rast mos zgjidhjeje të ankesës, ja paraqet atë Dekanit për shqyrtim dhe vendimmarrje. Dekani,</p>






	<p>brenda 48 orëve nga marrja në dijeni për ankesën, ngre komision ad-hoc, i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit dhe ky komision përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. (Ref. 2.1 Rregullore UT-së. Neni 51)</p> <p>Si rregull materialet e provimeve ruhen në ambientet e Departamentit deri në fund të semestrit pasardhës dhe më pas digjen. Ato mund të rishihen vetëm në rast ankimimi ose në rast kontrolli nga autoritete drejtuese, (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit, neni 13.9/ 13.10)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i referencës në RVB të planit mësimor për programin e studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndët bazë (A) zënë 18.8 %; - lëndët karakterizuese (B) zënë -57 %; - lëndët ndërdisiplinore (C) zënë 11.1%; - lëndët plotësuese (D) zënë 11.1%; - detyrimet përmbyllëse zënë (E) 3-5%; <p>Ref 1.12 Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze).</p> <p>GVJ vëren se veprimtaria formuese në këtë plan mësimor (mësimi në auditor dhe jashtë tij) është ndërtuar në funksion të formimit të studentëve. Lëndët karakterizuese të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze shërbejnë në zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve sipas profileve të programit Bachelor në Gjuhë angleze me profile: gjuhë angleze/ Përkthim-Interpretim dhe Studime Britanike dhe Amerikane. (Ref 2.5 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) Tabela 9.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit</p>	<p>GVJ konstaton nga shqyrtimi planit mësimor të Programit të</p>

<p>garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" se lëndët ndërdisiplinore (B) të ofruara për këtë program të tilla si: Informatikë, shprehi studimi dhe parashtrimi, ekonomi tregu, marrëdhënie publike, përkthim i teknologjisë juridike, sociolinguistikë, element të qytetërimit në gjuhën (C) dhe lëndët plotësuese(D) gjuhë e huaj, informatikë garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, shkencave humane, komunikimit dhe ndërveprimit. (Ref. 2.5 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E, 2020-2023, Tabela 9)</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, GVJ evidenton se kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti të përfshira në programin e studimit analizohen në Raportin e vlerësimit të studentëve të diplomuar, të hartuar nga NJSBC, i cili i vihet në dispozicion organeve drejtuese të fakultetit, si edhe përgjegjësit të departamentit të gjuhës angleze. (Ref 3.5 Raporti i Vlerësimit të studentëve të diplomuar, viti akademik 2021-2022).</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Gjithashtu, GVJ konstaton referuar RVB, se personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre duke zhvilluar diskutime në përfundim të lëndëve përkatëse. Gjithashtu, personeli akademik për përmbushjen e objektivave mësimorë përgjatë periudhës së pandemisë ka zhvilluar me studentët konsula në distancë edhe në auditor në respektim të rregullores së brendshme e UT-së për mbrojtjen nga virusi Covid 19. (Ref. 3.18 shkresë planifikimi i Orarit të konsultave, (Ref. 3.9 Rregullore e brendshme e UT-së "Për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi Covid 19).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se FGjH ka hartuar strategjinë e teknologjisë dhe inovacionit, e cila ka parashikuar në vizionin e saj përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të personelit akademik (Ref 3.17 Strategjia e teknologjisë dhe inovacionit së FGJH). GVJ evidenton se personeli akademik ka realizuar orë të hapura dhe seminare, të cilat ofrohen nga DGJA nëpërmjet zbatimit të projekteve, në të cilat ky departament është pjesëmarrës partner, si për shembull Projektit Re@WBC, ku evidentohet se është realizuar trajnimi nga përfaqësues të DGJA sipas modelit "train the trainer". (REF. https://fgjh.edu.al/?s=teaching+methodology; Ref.Vizita ne institucion)</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se janë organizuar trajnime me</p>





	<p>auditor të zgjeruar për prezantime të teknologjive të ndryshme në funksion të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. https://fgjh.edu.al/cikli-i-trajnimeve-mbi-teknologjite-e-reja-ne-mesimdhenie-me-temen-nderveprimi-me-ndihmen-e-mjeteve-teknologjike-bashkepunuese/.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Duke iu referuar dokumentacionit të paraqitur në DVV, konkretisht, planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze dhe programeve të lëndëve/sylabuset, GVJ konstaton se mësimdhënia realizohet mbi bazën e kompetencave, të cilat janë parashikuar në formën e realizimit të detyrave të kursit ose zhvillimit të orëve të mësimit në laborator kryesisht për lëndët karakterizuese, ku teoria përthyer në praktikë. Këto detyrime, që njëkohësisht janë edhe format të vlerësimit të studentit, kanë peshë 15-20% të vlerësimit përfundimtar të lëndës.</p> <p>(Ref 2.10 Dosja me programet lëndore. Ref 2.5 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) 2020-2023, Tabela 9; Ref. 3.15 Aneks RVB- Format e kontrollit të njohurive, Tabela 15)</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Sipas informacionit të paraqitur në RVB dhe duke iu referuar programeve të lëndëve (sylabuseve), GVJ konstaton se personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup, për shkak të natyrës interaktive që programi i studimit Bachelor në gjuhë angleze ka. Detyra e kursit e përfshirë në çdo sylabus, është mundësi konkrete për realizimin e punës në grup. (Ref. 2.10 Programet e lëndëve)</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur në DVV konstatohet nga GVJ se personeli akademik krijon kushte të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të avancuara shkencore dhe mbështetje të studentëve. Referuar RVB dhe vizitës në institucion GVJ raporton se studentët e Ciklit të Parë të studimeve, Bachelor në Gjuhë angleze janë angazhuar në dy projekte shkencore individuale të pedagogëve, njëri prej të cilëve ka patur si produkt zhvillimin e një ore mësimore në klasat e gjashta në një shkollë 9-vjeçare. Ndërsa projekti i dytë finalizohet me zhvillimin e konferencës së dytë studentore. (Ref. 3.20.1 Programi i konferencës 2nd Junior Conference Në dimensions and approaches in English Studies).</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës mbështet zhvillimin e ideve inovatore, studimet e avancuara dhe mbështet financiarisht studentët. Për programin e studimit Bachelor në gjuhë angleze ky vizion është i shprehur nëpërmjet organizimit të konferencave ndërkombëtare studentore dhe</p>


	publikimit të abstrakteve të punimeve në faqen zyrtare të FGJH (Ref. 3.14 Plani i kërkimit shkencor të UT-së, 2018-2022, pika 2. www.fgjh.edu.al/konferenca-nderkombetare-studentore/www.fgjh.edu.al/abstraktet-e-junior-conference/)			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Referuar RVB-së dhe dokumentacionit të paraqitur në DVV, konstatohet nga GVJ se personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese dhe ka rritur mobilitetin e studentëve të FGJH. Konkretisht në kuadër të Projektit Erasmus + UT ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi Erasmus + ICM me universitete të ndryshme partnere me një total prej 109 studentësh për periudhën 2016-2020, nga të cilët 15 studentë nga ky mobilitet i perkasin programit të studimit Bachelor në gjuhë angleze për periudhën 2018-2021, ndërsa 18 janë staf akademik. (Ref. Dok. Shtesë, Pika 10. Të dhëna për mobilitetin e stafit dhe studentëve për programin e studimit)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Referuar dokumentacionit shoqërues në RVB, evidentohet nga GVJ se përmbyllja e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" realizohet me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe përmban 4 kredite. (Ref. 1.6 Rregullore e programit të studimit, neni 19. Pika 19.1, 19.2, 19.3). FGJH harton procedurë të posaçme për provimin final para diplomimit dhe bën publike procedurën në faqen zyrtare elektronike të institucionit. (Ref: www.fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2021/04/programi-per-provimin-perfundimtar-te-formimit-GJUHE-ANGLEZE--1-1.pdf) Gjithashtu GVJ konstaton nga vizita në institucion se para zhvillimit të provimit final të diplomimit zhvillohet një takim informues me studentët e vitit të fundit, përgjegjësin e DGJA, si dhe sekretarisë mësimore. <i>Në rregulloren e FGjH nuk parashikohet procedura e informimit të studentëve, si edhe është e përcaktuar në</i>




	<p><i>Rregulloren e UT-së.</i></p> <p>(Ref.2.1 Rregullore e UT, neni 59; Ref. 2.1.1 Rregullore e brendshme e FGJH)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi informacionin në RVB dhe dokumentacionin shoqërues konstaton se personeli akademik i DGJA harton fondin e pyetjeve për programin e formimit mbështetur në objektivat e programit të provimit të formimit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit, neni 19. Pika19.3) Referuar RVB dhe nga dokumentacioni shoqërues i tij, GVJ konstaton se fondi i pyetjeve përfshin 12 Module nga profili 'Gjuhë Angleze; 5 Module Përkthim-Interpretim dhe 13 module Studime Britanike dhe Amerikane. (Ref. 3.23 Model programi të provimit përfundimtar për profilet Gjuhë angleze/ Përkthim- Interpretim, Studime Britanike dhe Amerikane, viti 2020-2021).</p> <p>Mënyra e zhvillimit të provimit final për programin e studimit Gjuhë angleze është parashikuar që kryhet nëpërmjet shkrimit të 3 eseve me natyrë formuese në bazë të përzgjedhjes së 3 fushave nga programi i provimit të formimit, të cilat përmbajnë pyetje orientuese nga modulet e lëndëve që janë përfshirë në programin e studimit bachelor gjuhë angleze. Titullarët e lëndëve bazë më të rëndësishme, atyre karakterizuese dhe ndërdisplinore krijojnë një fond me tema esesh, nga të cilat studentët mund të zgjedhin temën në ditën e provimit. (Ref 3.22 Rregullore e Diplomimit të Programeve studimit të Ciklit I- Bachelor, Neni 6; Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit, neni 19).</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>GVJ konstaton nga shqyrtimi dokumentacionit shoqërues i RVB-së, si edhe nga vizita në institucion në takim me studentët dhe personelin akademik, se përveç shpalljes në versionin elektronik të programeve të provimit të formimit, studentëve u dërgohen programet e provimit të formimit në fillim të semestrit të dytë. Gjithashtu studentëve iu dërgohen edhe modele të eseve të viteve të mëparshme apo udhëzime ad-hoc për hartimin e eseve në varësi të specifikave të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. Referuar RVB-së dhe nga vizita në institucion, rezulton se studentët, përpara provimit të diplomimit, marrin udhëzime të detajuara mbi procedurën e zhvillimit të provimit, kriteret e vlerësimit dhe mënyrën se si bëhet shpallja e vlerësimit përfundimtar. (Ref 3.22 Rregullore e Diplomimit të Programeve Studimit të Ciklit I- Bachelor, Neni 6, pika 2. a/b).</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ referuar informacionit në RVB edhe dokumentacionit shoqërues nuk konstaton se evidentohen të dhëna që FGJH asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze, kjo edhe për shkak të natyrës karakterizuese të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ duke iu referuar RVB-së dhe kuadrit rregullator për diplomimin e studentëve të Programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" konstaton se programi i studimit nuk përmbyllet nëpërmjet punimit të temës së diplomës, por me provim përfundimtar. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit, neni 19).</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur në DVV, konstatohet nga GVJ se provimi përfundimtar vlerësohet me notë dhe mbart kreditet e përcaktuara (4 Kredite). Sistemi i vlesimit me notë është shpëradarë sipas përqindjeve të caktuara për 4 komponentët e provimit përfundimtar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nota mesatare e 3 viteve të studimeve - 40%; 2. Vlerësimi për esenë 1- 20%; 3. Vlerësimi për esenë 2- 20%; 4. Vlerësimi për esenë 3- 20%; <p>Rezultati përfundimtar u komunikohet individualisht studentëve dhe shënohet në procesverbal.</p> <p>(Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit, neni 19.pika 19.4/e Ref 3.22 Rregullore e Diplomimit të Programeve studimit të Ciklit I- Bachelor, Neni 6)</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni në DVV dhe nga vizita në institucion se pasi studentët kanë shlyer të gjitha detyrimet e programit Bachelor në Gjuhë Angleze, përfshirë detyrimet financiare apo materiale kundrejt universitetit, pajisen me diplomë dhe suplementin e saj, të miratuar me vendim Senati Nr. 28 të UT-së 'Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës të UT-së. (Ref.1.2 Statuti neni 89, 110 dhe 111; Ref 2.1 RRegullore UT, Neni 60-64; Ref 3.24.1. Model Suplementi 3.24.1). Në përfundim të studimeve, me kërkesë të studentit, atij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, me kërkesë të studentit, atij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar,</p>




(Ref.1.2 Statuti UT, neni 111).
GVJ rekomandon që këto procese të reflektohen në dokumentin qendror rregullator të FGjH, Rregulloren e brendshme të tij (Ref. 2.1.1 Rregullore e brendshme e FGJH).

Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.

Mbështetur në infomacion e RVB-së dhe dokumentacionin e paraqitur në DVV, si edhe në vizitën në institucion, GVJ konstaton se sekretaria mësimore e FGjH disponon në formatin fizik: regjistrin themeltar të studentëve me të dhënat personale; regjistrin themeltar të arritjeve akademike të studentëve me vlerësimin e tyre (me notë dhe fjalë) dhe regjistrin themeltar për lëshimin e diplomave dhe çertifikatave të studentëve (numri i diplomës, datën e diplomimit dhe datën e tërheqjes së diplomës dhe Supplementit të diplomës). **(Ref. 5.26. Udhëzim nr 16-dt. 08.07.2019 `Për pajisjen e IAL-ve me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike, regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave).**

GVJ konstaton se regjistri themeltar rezulton i plotësuar me shkrim dore pa korigjime, nuk ndryshon për asnjë arsye dhe ruhet për periudhë të pacaktuar kohore në formë fizike. Përpunimi dhe administrimi i të dhënave personale të studentëve bëhet nga ana e sekretarisë mësimore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri. **(Ref. 2.1 Rregullore UT-së, Neni 42).**



GVJ konstaton se në kohën e vizitës në institucion pranë sekretarisë mësimore nuk ishte instaluar sistemi dixhital, i cili mundëson komunikimin e vlerësimeve të studentëve, apo të dhënave të tjera në lidhje me këtë strukturë, sipas regjistrin themeltar, nëpërmjet aksesit të drejtëpërdrejtë nga llogaria e tyre elektronike. Ky sistem ishte funksional nga viti 2011 deri në vitin 2017. GVJ konstatoi gjatë vizitës se sekretaria mësimore e FGjH është në tratativa për ndërtimin e këtij sistemi digjital.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni ka në organikën e tij Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, e cila është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”. (Ref 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës Vendim i Senatit Akademik Nr. 30, datë 14.09.2018)</p> <p>Gjatë takimit me përgjegjësen e Zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ konstatoi se kjo strukturë dispononte dosjet e personelit akademik, ndihmës akademik për çdo program studimi të FGJH. (Ref 4.1 Vendim nr. 39 datë 04.04.2018 Bordi i Administrimit UT). Në mënyrë rastësore, GVJ shqyrtoi dosjet personale të dy pedagogëve të punësuar me kohë të plotë pranë këtij departamenti dhe konstatoi se dosjet e personelit përmbanin të dhënat personale, kualifikimet e përditësuara në mënyrë periodike, kontratën e punës, etj (Ref 4.2 Formularë të dosjes fizike të plotë nga BNJ)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për administrimin e strukturës së personelit akademik. Ngritja dhe funksionimi i kësaj strukture bazohet në nenet 64, 65 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore të IAL. Kjo zyrë administron dokumentacionin dhe procedurat e ndjekura për rekrutimin e personelit akademik. (Ref 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës; 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës). Rekrutimi i këtij personeli mbështetet në procedurat e përcaktuara nga Statuti i UT-së dhe kryhet përmes një procedure të hapur, transparente, të paanshme dhe objektive. Statuti parashikon qartë kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët dhe hapat e procedurës që duhen ndjekur. (Ref 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës)</p> <p>Manuali për punësimin e personelit përshkruan hapat që duhet të ndiqen për rekrutim ku përfshihen shpallja e vendit të lirë, njoftimi zyrtar në faqen Web të UT-së dhe prokurimet publike, kriteret dhe afatet e aplikimit dhe strukturat përgjegjëse për vijimin e procedurës së plotë të rekrutimit. (Ref 4.4 Manual mbi punësimin e personelit në UT, Vendim nr.2, datë</p>

	24.01.2022); (Ref 4.4 Manual mbi punësimin e personelit në UT, Vendim nr.2, datë 24.01.2022)			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Bazuar në statutin e Universitetit të Tiranës, GVJ konstatoi se, njësia bazë përcakton dhe harton procedurat dhe kriteret e veçanta për rekrutimin e personelit duke pasur parasysh nevojat e programit, specifikat e tij dhe kriteret e vendit të punës. (Ref 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës; 4.3 Dosje e plotë rekrutimi) . Dekani i FGJH-së i përcjell me shkresë Rektorit, i cili është autoriteti vendimmarrës, dosjen me dokumentacionin e lartpërmendur.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të paraqitur nga GVV, Statuti i Universitetit të Tiranës përcakton kriteret e përgjithshme dhe specifike, si dhe procedurat e vlerësimit për përzgjedhjen e personelit (Ref 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës) . Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga një komision ad-hoc i ngritur nga Rektori, i përbërë nga 5 anëtarë, tre nga Njësia Bazë, një përfaqësues nga Njësia Kryesore dhe një përfaqësues nga Rektori i UT-së. Kandidatët e skualifikuar ruajnë të drejtën e ankimimit. (Ref 4.3 Dosje e plotë rekrutimi)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit plotësues të përfshirë në DVV, u konstatua se FGJH-ja ka në përdorim me kohë të plotë dy godina A dhe B, si dhe Godinën Iliria, e cila plotëson nevojat e këtij fakulteti. (Ref. 4.6 Përdorimi i godinës Iliria Orari; 3.7 Aneks RVB Mjediset e Fakultetit, njësie bazë, tabela nr.16) . Mjediset ofrojnë standard të kënaqshëm dhe ndihmojnë në kryerjen e proceseve të mësimdhënies, kërkimit shkencor, funksioneve administrative dhe aktiviteteve të tjera. (Ref 1.15 Rapori vjetor i FGJH-së për vitin akademik 2019-2020; 1.16 Raporti vjetor i FGJH-së për vitin akademik 2020-2021; 4.7 Raporti përfundimtar i auditimit

	<p>2021)</p> <p>FGJH disponon 33 auditorë për seminare dhe 5 salla leksionesh me kapacitet 526 vende. (Ref 4.15 Godinat e Univesitetit të Tiranës). Ka 5 laboratorë të pajisur me teknologji bashkëkohore në mbështetje të procesit mësimor. 4 auditore disponojnë tryeza smart të lidhura me projektorë dhe sistem audio. 2 laboratorë multimedialë janë të pajisur me programe bashkëkohore për lëndë që kërkojnë zhvillimin e veprimtarive praktike. Auditorët e seminareve janë të pajisur me videoprojektorë dhe çdo department disponon një kompjuter lap-top. Çdo mjedis i fakultetit mbulohet nga sistemi Wi-Fi. Sallat e bibliotekave, prej 242 m² janë të pajisura me kompjuter, printer, fotokopje, videoprojektorë. Biblioteka ka një kapacitet prej 15.965 titujsh.</p> <p>(Ref 1.5 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të huaja 2021-2024; 1.4 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>UT-ja dhe FGJH-ja kanë parashikuar në strategjitë e zhvillimit të tyre, objektiva të qarta për kualifikimin dhe ngritjen profesionale të personelit akademik. (Ref 1.4 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023; 1.5 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të huaja 2021-2024) Në kuadër të këtij plani zhvillimi, FGJH-ja ka ofruar mbështetje financiare për pjesëmarrje individuale të personelit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë vizitës në IAL, GVJ u informua nga Dekania e Fakultetit për mënyrën se si sigurohej financimi i stafit nga ana e institucionit, mbështetje e cila kryesisht realizohej përmes projekteve të financuara nga vetë institucioni, AKSH-i apo partnerë ndërkombëtarë. (Ref 4.1 Vendim nr. 39 datë 04.04.2018 Bordi i Administrimit UT)</p> <p>Institucioni gjithashtu inkurajon projekte dhe studime të thelluara postdoktorale nëpërmjet Vitit sabatik, parashikuar në nenin 73 të Statutit të UT-së. Nga informacioni i marrë nga dokumentacioni mbështetës, gjatë vitit akademik 2019-2020 ka fituar vitin sabatik 1 pedagog efektiv i DGJA, ndërsa gjatë vitit 2021-2022 kanë fituar të drejtën 2 pedagogë. (Ref. 4.16 Të dhëna për stafin akademik që ka aplikuar për vitin sabatik). Manuali i vlerësimit të performancës së stafit akademik mat dhe vlerëson arritjet profesionale dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik. (Ref 1.20.1 Manual i cilësisë)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni</p>	<p>Në përputhje me objektivat dhe planet strategjike që synojnë</p>






<p>organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, njësia kryesore dhe njësia bazë sigurohen që personeli akademik të jetë i angazhuar në përdorimin e metodave dhe teknologjive të reja për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Me këtë qëllim, FGJH ka hartuar edhe një plan strategjik për teknologjinë dhe informacionin, i cili synon trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik dhe përmirësimin dhe zgjerimin e strukturave mbështetëse akademike. (Ref. 3.17 Strategjia e teknologjisë dhe inovacionit në mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhjetor 2021)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë GVJ, rezulton se shpërndarja e ngarkesës mësimore për stafin akademik efektiv të angazhuar në mësimdhënie pranë DGJA, kryhet në përputhje me programin mësimor, bazën ligjore mbi të cilën mbështetet përcaktimi i ngarkesës minimale dhe maksimale dhe përshtatja me kualifikimet e stafit akademik. (Ref. 2.6 Aneks RVB Ngarkesa e stafit akademik të programit të studimit)</p> <p>Ngarkesa mësimore dhe orari mësimor përcillen zyrtarisht në Dekanat dhe Rektorat.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar tek informacioni i dhënë në DVV, GVJ vlerëson se FGJH shfrytëzon në funksion të veprimtarisë mësimore të gjitha mjediset e tij me kapacitet të plotë. Orari i mësimit është organizuar në dy fasha. Gjatë vizitës pranë mjediseve të FGJH-së, GVJ konstatoi se studentëve të programit Bachelor në “Gjuhë Angleze” u janë vënë në dispozicion 2 auditorë leksionesh me kapacitet 218 vende, të pajisur me tryeza inteligjente, projektor, sistem audio dhe Wi-Fi. Sallat janë të ndriçuara mirë, të pajisuara me kondicionerë dhe sistem ngrohjeje qëndrore. (Ref 2.22 Inventari i auditorëve)</p> <p>Sallat e seminareve në funksion të zhvillimit të veprimtarisë mësimore janë të pajisura me videoprojektorë, tabela</p>

	<p>interaktive Wi-Fi dhe kushte optimale të ndriçimit dhe temperaturës. Në kushte specifike dhe në varësi të natyrës së lëndës, vihen në përdorim të procesit mësimor edhe sallat e bibliotekave, Salla Europa dhe laboratorët multifunksionalë. (Ref 2.22 Inventari i auditorëve)</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në mjediset e FGJH-së, ku zhvillojnë mësimin studentët e programit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, GVJ konstatoi se auditorët ishin të pajisur me mjete elektronike si kompjuter, lap top, tabela interaktive, pajisje fonie etj. GVJ vizitoi disa salla leksionesh, seminaresh, laboratorësh, dy salla bibliotekash dhe vuri re se mjediset dispononin mjete dhe pajisje që viheshin në dispozicion të procesit mësimor. Nga takimet e zhvilluara me stafin akademik, GVJ konstatoi se institucioni organizon trajnime dhe përditësime për të rejtat e teknologjisë në bashkëpunim edhe me institucione të tjera.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Pasi shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ vizitoi nga afër mjediset e FGJH-së, nga ku konstatoi se sallat e laboratorëve disponojnë pajisje si kompjuter dhe laptop të pajisur me programe kompjuterike, menaxhimi-regjistrimi, përkthimi-interpretimi, tabela interaktive etj. (Ref 2.22 Inventari i auditorëve)</p> <p>Sallat e bibliotekave gjithashtu ishin të pajisura me kompjuter, printer, fotokopje, projektor dhe një numër të madh titujsh. Gjatë takimit me një grup studentësh të programit, ata pohuan se i shfrytëzonin mjediset e laboratorëve dhe bibliotekave gjatë procesit të mësimdhënies</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ vizitoi laboratorët e vënë në dispozicion nga FGJH-ja. Nga takimi me studentët, gjithashtu u theksua fakti se institucioni u krijon atyre kushte të favorshme për përdorimin e pajisjeve personale smart brenda mjediseve të fakultetit. (Ref 4.18 Manual për përdorimin e Microsoft Teams për stafin akademik)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Takimi me personelin akademik dhe studentët rikonfirmoi faktin se institucioni krijon mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive ekstrakurrikulare në mbështetje të procesit mësimor. FGJH-ja dhe DGJA-ja bashkëpunojnë dhe lidhin marrëveshje me institucione dhe organizata të tjera për të ofruar shërbim sa më cilësor. Nga të dhënat e marra në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar në rang fakulteti/departamenti rezulton se për vitin akademik 2019-2020 janë realizuar 5 projekte ndërkombëtare me përfitues 30 punonjës të stafit akademik.</p>

	Po për të njëjtin vit numri i leksioneve të realizuara nga lektorë të huaj është 8, ndërsa mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programeve të studimit është 35 dhe 6. Për vitin akademik 2020-2021, stafi akademik është përfshirë në 5 projekte fitues me 30 përfitues. 10 orë leksionesh janë zhvilluar nga lektorë të huaj dhe 19 studentë kanë kryer mobilitete në universitete jashtë vendit. (Ref. 2.14 Aneks RVB Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të fakultetit Tabela 20)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekave të FGJH-së, shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga bashkëbisedimi me studentët e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, GVJ konstatoi se studentët dhe personeli akademik i këtij programi shfrytëzojnë dy salla të mëdha të vendosura në godinën e FGJH-së, kati i dytë. Studentëve gjithashtu u sygjerohej dhe u ofrohej mundësia e përdorimit pa pagesë dhe pa limit të dy bibliotekave online, sikurse dhe një platforme online (Rosseta Stone) për mësimin e gjuhëve. GVJ vlerësoi nga afër fondin e pasur të bibliotekave me një numër të madh titujsh librash, artikujsh, studimesh në disa gjuhë të huaja.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, vizitës në mjediset e bibliotekave dhe bashkëbisedimit me personel akademik dhe studentë rezulton se bibliotekat e FGJH-së ofrojnë një fond të pasur librash në gjuhësi, histori, letërsi, përkthim, dhe metodologji në anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht, turqisht dhe gjuhët sllave. Pjesa më e madhe e titujve ka funksion të lidhur me mësimdhënien dhe mësimnxënien. 60% e fondit i takojnë letërsisë. 2332 tituj në 4209 kopje ofrohen në gjuhën angleze. (Ref 4.12 Dorëzimi i parë i teksteve, datë 30.03.2022; 3.7 Aneks RVB Mjediset e

studimit.	fakultetit, njësisive bazë)			
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Studentët vlerësojnë mundësinë për të pasur akses të plotë në përdorimin e bibliotekave fizike dhe virtuale të FGJH-së. Bibliotekat virtuale u vihen në shërbim studentëve nëpërmjet rregulloreve individuale, marrëveshjeve institucionale dhe manualeve të përdorimit. (Ref 4.1 Vendim nr. 39, datë 04.04.2018, Bordi i Administrimit)			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekave, GVJ vërejtë se sallat e bibliotekave ishin të pajisura me teknologjinë bashkëkohore dhe dispononin kompjuter të lidhur me internet, printer, fotokopje, videoprojektorë. (Ref 4.12 Të dhëna për bibliotekat; 3.7 Aneks RVB Mjediset e fakultetit, njësisive bazë).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	<p>Institucioni, në bashkëpunim me stafin e bibliotekës, personelin akademik dhe studentët e programit, planifikon në mënyrë periodike shtimin e fondit të librave me tituj të rinj. GVJ gjatë takimit me stafin akademik të programit, u informua se njësitë përgjegjëse i marrin në konsideratë kërkesat e tyre për përditësim të literaturës që ata shfrytëzojnë, me tituj të rinj. (Ref 3.7 Aneks RVB Mjediset e fakultetit, njësisive bazë; 4.12 Të dhëna për bibliotekat; 4.19 Rregullore e brendshme e degës së sekretarisë mësimore e FGJH-së, vendim nr. 32, datë 18.03.2022).</p> <p>Bazuar tek dokumentacioni mbështetës, GVJ konstatoi se në parashikimet e bëra në fillim të vitit akademik, në buxhet programohet edhe një fond i caktuar për të përmbushur këto kërkesa. Në vitin 2020 janë shtuar 233 kopje, me një buxhet prej 1.315.851 lekë. (Ref.4.20 Realizimi i buxhetit 2018; 4.21 Pasqyra financiare për vitin 2019; 4.23 Miratimi i detajimit të grantit të mësimdhënies nga buxheti i shtetit)</p>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Gjatë takimit në mjediset e bibliotekës, personeli përgjegjës theksoi edhe një herë orarin e funksionimit të bibliotekës (Ref 4.10 Rregullore për bibliotekat) dhe faktin se ky orar kufizohet vetëm në rastet kur mjediset e saj shfrytëzohen në mbështetje të procesit mësimor, trajnimeve apo veprimtarive të tjera të institucionit. Në këto raste shërbimi mbështetet në sallën tjetër. Bibliotekat online funksionojnë me një shërbim 24/7.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Dokumentacioni i plotësuar nga GVB përcakton qartë se në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktara në ligjin LAL 80/2015 dhe Statutit të UT-së, neni 124, FGJH ka detyrimin të ruajë dhe të administrojë informacionin e lidhur me studentët, që nga regjistrimi e deri në diplomimin e tyre. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ verifikoi regjistrin themeltar të studentëve; regjistrin e arritjeve akademike; regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.</p> <p>GVJ konstatoi se sekretaria mësimore administron të dhënat e studentëve, përpunon dhe arkivon procesverbalet dhe dokumentacione të tjera lidhur me cilësinë akademike të studentëve sikurse plotëson dhe certifikon suplementin e diplomës. (Ref 4.19 Rregullore e brendshme e degës së sekretarisë mësimore e FGJH-së, vendim nr. 32, datë 18.03.2022)</p> <p>Gjatë takimit me punonjësit e sekretarisë mësimore të FGJH-së, GVJ konstatoi se sekretaria mësimore disponon një sistem të brendshëm administrimi elektronik. Të dhënat e sistemit vihen në shërbim të sektorëve të tjerë dhe studentëve.</p> <p><i>Grupi i ekspertëve konstatoi mungesën e një sistemi digjital të sekretarisë mësimore, i cili do të lehtësonte procedurat e ruajtjes, menaxhimit dhe shpërndarjes së të dhënave sikundër dhe ndërvprimin më efikas të kësaj strukture me studentët dhe personelin akademik.</i></p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Informacioni dhe dokumentacioni i veprimtarisë së personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ ruhet dhe administrohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës. Njësia bazë, DGJA, gjithashtu ruan dhe dokumenton informacion fizik dhe elektronik për stafin akademik dhe e përditëson periodikisht atë.</p>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të	<p>Studentët dhe stafi akademik mund të sigurojnë dhe të aksesojnë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm,</p>

dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	nëpërmjet faqeve Web të FGJH-së dhe DGJH-së. (fgjh.edu.al; fgjh facebook) apo dhe strukturave të tjera siç është Dekanati.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sipas të dhënave të paraqitura në DVV, personeli akademik dhe studentët e UT-së komunikojnë dhe shkëmbejnë informacion përmes platformës Microsoft Teams. (Ref 3.8 Shkresë nr. 26.5 Mbi platformën Microsoft Teams for Education për zhvillimin e mësimi online; 4.18 Manual për përdorimin e Microsoft Teams për stafin akademik) Stafit dhe studentët janë të pajisur me adresa emaili zyrtare të UT-së.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sipas RVB-së rezulton se sistemi i menaxhimit të informacionit sipas sektorëve të ndryshëm është aktiv dhe ofron informacion për veprimtarinë akademike dhe administrative në kohë reale. Gjatë vizitës në institucion, GVJ-së iu konfirmua nga personeli akademik dhe ndihmës akademik, se sistemi i menaxhimit të informacionit në DGJA u mundësonte drejtuesve dhe titullarëve të institucionit komunikim të shpejtë dhe efikas. (Ref 2.19 Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore të DGJH-së për periudhën 1.10.2019-30.09.2021 2.20 Raport për veprimtarinë kërkimore-shkencore për periudhën 1.10.2020-30.09.2021).			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstatoi se faqja e internetit përmban informacion të zgjeruar, të përditësuar dhe lehtësisht të aksesueshëm. (Ref 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës) Të dhënat për programin e studimit Bachelor në “Gjuhën angleze”, programet e lëndëve dhe planet mësimore jepen në gjuhën shqip dhe anglisht, ndërsa informacioni mbi veprimtaritë akademike, kurrikulare dhe ekstrakurrikulare vetëm në gjuhën shqipe. Sektori i IT-së të FGJH-së, është përgjegjës për monitorimin dhe mirëmbajtjen e faqes. (Ref 4.1 Vendim nr. 39, datë 04.04.2018 Bordi i Administrimit, neni 10)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të

studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të paraqitur në DVV, në fillim të çdo viti akademik, njësia kryesore harton dhe paraqet raportin vjetor në të cilin përfshihet analiza e realizimit të buxhetit financiar dhe parashikimi për vitin pasardhës.</p> <p>Tarifat e studimit përcaktohen në bashkëpunim me Qeverinë, e cila siguron çdo vit grantin e mësimdhënies dhe grante të tjerë bazuar në nenet 108,109,110,111,112, të LAL 80/2015.(Ref 4.20 Realizimi i buxhetit; 4.21 Pasqyra financiare; 4.22 Realizimi i të ardhurave për vitin 2020)</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Në dokumentacionin e paraqitur nga GVB, sqarohet se planifikimi vjetor i buxhetit të njësisë bazë përfshin; financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet në mbështetje të kërkimit shkencor, shpenzimet në teknologji informacioni, laboratorë, mjete mësimore, literaturë etj. Ky parashikim përcillet në dekanat dhe më pas në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit. (Ref 4.24 Buxheti i departamentit të gjuhës angleze).</p> <p>Gjatë takimit me personelin akademik të DGJA-së, pedagogët theksuan faktin se njësia kryesore mban parasysht nevojat dhe kërkesat e këtij departamenti, si njësia me ngarkesë më të madhe në numër studentësh dhe staf akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se auditimi i brendshëm periodik i gjendjes financiare kryhet nga Drejtoria e Auditimit të brendshëm, bazuar në Ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (Ref 4.25 Buxheti i konsoliduar 2021).</p> <p>Bashkëngjitur me dokumentacionin e paraqitur në DVV, është përfshirë analiza e realizimit të buxhetit financiar dhe detajimi i planit të buxhetit financiar për vitet; 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021. Raporti i detajuar certifikohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të Universitetit dhe kontrollonhet nga Ministria e Financave, bazuar në LAL 80/2015, neni 116, pika 2.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi,</p>	<p>Raportet e kontrolleve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm vlerësohen nga stafi akademik dhe ndihmës akademik</p>


institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	dhe kërkesat dhe nevojat specifike të tyre reflektohen në planet e ardhshme buxhetore dhe planet strategjike të njësisë bazë dhe asaj kryesore. (Ref 4.25 Buxheti i konsoliduar 2021).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar në DVV, GVJ konstatoi se Universiteti i Tiranës financohet nga buxheti i shtetit dhe ka në administrim fëndet e veta financiare që sigurohen përmes tarifave të studimit apo nga shërbimet e ofruara nga palët e treta (LAL 80/2015, neni 108). Njësia kryesore, FGJH-ja, harton planet buxhetorë vjetorë, në përputhje me kërkesat, nevojat dhe planin strategjik të zhvillimit të këtij institucioni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përkrahje përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përkrahje përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur për shqyrtim nga GVB, GVJ konstaton se hartimi i programeve të studimit të ciklit të parë kryhet në përputhje dhe procedurat e parashikuara në ligjin nr.80/2015 si dhe me aktet rregullatore në fuqi. (Ref 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës; 5.2 Vendim nr 5, datë 30.03.2021 Kriteret e pranimit për vitin

	<p>akademik 2021-2022).</p> <p>Studentët pranohen në programin e studimeve Bachelor në “Gjuhën Angleze” pasi kanë përmbushur detyrimet e parashtruara në pikën 1 të nenit 74 të ligjit nr.80/2015.</p> <p>Sipas dokumentacionit që përmban DVV, informimi dhe komunikimi me studentët bëhet përmes faqes zyrtare të FGJH, e- mailit personal të studentëve dhe platformës Microsoft Teams. (Ref 5.5 Kostoja e studimit për vitin I bachelor për vitin 2018-2019; 5.2 Vendim nr 5, datë 30.03.2021 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2021-2022).</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se rregulloret e njësive kryesore dhe atyre bazë sikurse dhe rregullorja e programit të studimit parashikojnë qartë kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur që nga pranimi i studentëve në këtë program studimi e deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësië e transferimit në programe të tjera. (Ref 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës;3.22 Rregullore diplomimi e programeve të ciklit të parë;3.23 Model programi të provimit përfundimtar në profilin Gjuhë Angleze ;3.23.1 Model programi të provimit përfundimtar në profilin Përkthim-Interpretim; 3.23.2 Model programi të provimit përfundimtar në profilin Studime Britanike dhe Amerikane).</p> <p>Në përfundim të ciklit të provimeve, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e saj, dokumentacioni i miratuar nga Ministria e Arsimit. (Ref 3.24 Model suplementi).</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Pranimi i studentëve në programin e studimit Bachelor në “Gjuhën angleze” kryhet sipas procedurave dhe kriterëve të bazuara në legjislacionin në fuqi duke garantuar barazi gjinore dhe fetare dhe të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët për student. (Ref 1.2 Rregullore e Universitetit të Tiranës 2.1 Statuti i Universitetit të Tiranës 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze 5.6 Gender Equality at Universty of Tirana; 5.7 Strategjia e gjithëpërfshirjes për studentet me aftësi ndryshe).</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përfshirë në DVV, GVJ konstatoi se kandidatët e rinj pranohen në përputhje me kriteret e parashikuara në VKM-në nr.651, datë 03.10.2019. (Ref 5.8 VKM nr. 651, datë 03.10.2019; 5. 9 VKM 436 datë 03.06.2020; 5. 10 Urdhër i përbashkët nr. 3, datë 06.08.2020). Procedurat në dalje të studentëve përcaktohen nga Statuti i UT-së, Rregullorja e UT-së, Rregullorja e</p>




	<p>diplomimit dhe Rregullorja e programit të studimit Bachelor. (Ref 1.2 Rregullore e Universitetit të Tiranës; 2.1 Statuti i Universitetit të Tiranës: 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze; 3.22 Rregullore diplomimi i programeve të ciklit të parë)</p> <p>Bazuar në të njëjtat rregullore përcaktohen edhe kriteret e miratuara për transferime, njohje të studimeve (të mëparshme ose të pjeshme), vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Kriteret e përcaktuara bëhen publike përmes shpalljes në faqen zyrtare të UT-së dhe të FGJH-së dhe në këndin e njoftimeve pranë mjediseve të FGJH-së. Gjatë vizitës në institucion dhe takimin me studentët, GVJ konstatoi se këto kritere dhe procedura ishin lehtësisht të aksesueshme nga të interesuarit.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur nga GVB përcakton qartë se kriteret e miratuara për transferime dhe njohje të studimeve bazohen te Rregullorja e Universitetit të Tiranës, Rregullorja e programit të studimit dhe Rregullorja për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët. Kriteret e përcaktuara bëhen publike përmes shpalljes në faqen zyrtare të UT-së dhe të FGJH-së dhe në këndin e njoftimeve pranë mjediseve të FGJH-së, fakt të cilin e mbështetën edhe studentët gjatë vizitës në institucion. Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” pajisen me dije dhe njohuri të përgjithshme dhe aftësi profesionale në fushën e mësimdhënies, përkthimit dhe komunikimit. (Ref 1.12 Aneks RVB, tabela 10 Plani mësimor i programit të studimit; 5.12 Model broshure informuese, Udhëzuesi i studentit).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Dokumentacioni mbështetës i vënë në dispozicion për GVJ, sqaron mënyrën e përcaktimit të kritereve së përzgjedhjes së kandidatëve mbështetur në aktet e nxjerra nga MASR si dhe kriteret e veçanta të hartuara dhe të propozuar nga njësia bazë(DGJA) Ref 5.2 Vendim nr 5, datë 30.03.2021 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2021-2022)</p> <p>Lista e kandidatëve fitues bëhet publike para fillimit të vitit akademik. Vizita në institucion dhe takimet me anëtarë të personelit akademik dhe studentë konfirmoi fatin se numri i studentëve të pranuar në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” përputhej me mundësitë reale dhe konkrete të njësisë për zhvillimin e veprimtarisë mësimore në kushte normale. (Ref 1.2 Rregullore e Universitetit të Tiranës; 5.10 Ref 5.10 Urdhër i përbashket nr. 3, datë 06.08.2020;</p>




	5.11 Kalendar i përbashkët i QSHA-së dhe RASH-it).			
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret e përgjithshme dhe specifike hartohen në përputhje me aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe Senatit Akademik. (Ref 5.2 Vendim nr 5, datë 30.03.2021 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2021-2022) dhe mbështeten në nenin 25, pika 8 e ligjit 80/2015 dhe VKM e posaçme për kriterin e notës mesatare në hyrje të studentëve nr. 295, datë 10.05.2019. (Ref 1.2 Rregullore e Universitetit të Tiranës).			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Bazuar tek informacioni i paraqitur në DVV dhe i konfirmuar nga vizita në institucion, në fillim të çdo viti akademik, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja informon të interesuarit në lidhje me kriteret e përcaktuara për aplikimet në të gjitha programet e studimit që ky institucion ofron. Informimi bëhet përmes faqes zyrtare të UT-së dhe të FGJH-së, rrjetit social Facebook, njoftimeve të shpalluara në mjediset e FGJH-së, sekretarisë mësimore dhe Zyrës së Këshillit të Karrierës. Në takimin e zhvilluar me GVJ, studentët pohuan se kishin marrë informacion të plotë dhe të detajuar pikërisht përmes mjeteve të informimit të sipërpërmendura. FGJH-ja, organizon fushata informimi dhe veprimtari promovuese, si takime në mjediset e fakultetit apo këshillim dhe promovim online me nxënësit e shkollave të mesme. Gjatë takimit me përfaqësues të organeve drejtuese të fakultetit, anëtarët e GVJ u njohën edhe me guidën informuese që ky institucion kishte hartuar me këtë qëllim. (Ref. 5.16 Shkresë datë 22.02.2022 ;5.17 Shkresë nr. 261 datë 10.03.2022;5.12 Model broshure informuese, Udhëzuesi i studentit)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në	GVJ konstaton se UT-ja dhe FGJH-ja ve në dispozicion informacionin e nevojshëm në lidhje me procedurat dhe kriteret e pranimit. Informacionet e nevojshme jepen përmes

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


<p>lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>njohjes së studentëve me rregulloren e programit të studimit, takimeve informuese me studentët, pedagogut të lëndës, sekretarisë mësimore dhe standës së DGjA. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze; 4.19 Rregullore e brendshme e degës së sekretarisë mësimore).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar tek materiali i paraqitur në DVV dhe vizitës në institucion me grupe studentësh, GVJ konstatoi se studentët informohen në lidhje me programin e studimit, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen dhe afatin e përfundimit, datën e fillimit të vitit akademik, grafikun e provimeve. Studentët konfirmuan se ishin të informuar në lidhje me kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze; 3.22 Rregullore diplomimi e programeve të ciklit të parë).</p> <p>Në rastin e programeve të shkëmbimit Erasmus, DGJA-ja kryen procedura njohjeje për periudhën kur studenti kryen këtë program. Gjatë takimit, studentë të këtij programi ndanë përvojat e fituara nga pjesëmarrja në Exchange Program Erasmus+ (Ref 5.18 Shkresë për ngritjen e komisionit të ekuivalentimit; 5.19 Model praktike, rifillim studimesh, ekuivalentim:5.19.1 Procedurë për mobilitet studimi; 5.18 Shkresë për ngritjen e komisionit të ekuivalentimit; 5.19 Model praktike, rifillim studimesh, ekuivalentim; 5.19.1 Procedurë për mobilitet studimi).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në dokumentacionin e paraqitur nga GVB dhe takimet e zhvilluara në institucion me anëtarë të stafit akademik dhe studentë u konstatua se DGJA-ja, ve në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve. Pedagogët dhe studentët pohuan se titullarët e lëndës informonin studentët mbi përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve që zhvillohen, vlerësimet e marra nga provimet e ndërmjetme, seminareve, detyrave të kursit, projekteve, prezantimeve dhe provimit përfundimtar. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, format e kontrollit të njohurive për studentët e programit Bachelor në “Gjuhë Angleze” përlllogariten si më poshtë;</p> <p>Njohja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive-10-15%;</p>




	<p>Plotësimi i detyrimeve(detyra kursi,laboratore)-15-20%;</p> <p>Testime gjatë vitit-20-30%;</p> <p>Provimi përfundimtar-40-50%;</p> <p>(Ref. 3.15 Aneks RVB Format e kontrollit të njohurive)</p> <p>Gjatë takimit me GVJ, studentë pohuan se ishin në dijeni të të drejtës për tu njohur me tezën e provimit pas korigjimit si dhe të pikëve are ed he pikëve në çdo rubrikë. Studenët njihnin të drejtën e ankimimit në rast mospajtimi me vlerësimin e marrë, madje ndanë edhe përvoja të ngjashme personale për rastet kur e drejta e tyre për ankimim ishte marrë parasysh, shqyrtuar dhe I ishte dhënë zgjidhja e duhur.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Sipas informacionit të paraqitur, diplomimi I studentëve të Gjuhës Angleze bëhet me provim formimi. Rregullorja e programit përcakton qartë kriteret dhe procedurat e provimit të formimit. Në përfundim të studimeve të ciklit të are Bachelor, studentit I lind e drejta të diplomohet në Bachelor në “Gjuhë angleze”, me profil “Përkthim-Interpretim”, “Gjuhë Angleze” dhe “Studime Britanike dhe Amerikane”. Përmbyllja e detyrimeve të programit të studimit të ciklit të are kryhet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me punim diplome. Detyrimi përmbyllës I këtij programi përlllogaritet nga 3% deri në 5% të krediteve në total ose 75-125, punë e pavarur e studentit, ngarkesë e parashikuar në planin mësimor. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze; 3.22 Rregullore diplomimi e programeve të ciklit të are). Studentët pohuan se kishin marrë informacion të plotë dhe ishin orientuar nga përgjegjësi I njësisë dhe pedagogët e DGJA-së në lidhje me fondin e pyetjeve të provimit të formimit dhe organizimin e provimit të diplomës që në fillim të vitit të tretë.</p>				
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>DGJA në bashkëpunim me FGJH promovon programet e ciklit të are të studimit për të gjithë maturantët. Takimet me pedagogë, studentë dhe përfaqësues të strukturave mbështetëse, përgjegjëse për informim, konkretisht Zyra e Këshillimit për Karrierën dhe e Studentit, konfirmuan se promovimi I programeve të studimit kryhet përmes takimeve për këshillim karriere, fushatat informuese, njoftimet për mobilitetet, panaiet e punës etj. Të gjitha veprimtaritë bëhen të njohura përmes faqes Web të FGJH-së. (Ref 5.17 Shkresë nr 261 datë 10.03.2022).</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="560 1877 754 1977">Përkrahje</td> <td data-bbox="754 1877 970 1977">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="970 1877 1177 1977">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1177 1877 1386 1977">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përkrahje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përkrahje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Pas shqyrtimit të materialit mbështetës të vënë në dispozicion dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se FGJH-ja organizon në fillim të çdo viti akademik një takim informues me studentët e vitit të parë. Gjatë këtij takimi, përgjegjësi i njësisë bazë së bashku me personelin akademik japin informacion mbi kurrikulat sikundër dhe orientojnë studentët e vitit të parë në lidhje me vendodhjen e mjediseve që shërbejnë për mësimdhënie, zyrave, sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës, orarin mësimor dhe përdorimin e faqes zyrtare të FGJH-së. (Ref 2.22 Inventari i auditorëve) Stafi akademik i njeh studentët me rregulloren e programit të studimit, formën e studimit, kreditet, ngarkesën në auditor, frekuentimin dhe format e vlerësimit. (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze) Gjatë periudhes së pandemisë, informacioni i nevojshëm u ofrua online, përmes platformës Teams. (Ref 1.2 Rregullore e Universitetit të Tiranës 3.9 Rregullore e brendshme e UT për rregullat e mbrojtjes nga virusi Covid 19; 2.5 Aneks RVB Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese)
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë takimeve të GVJ, të zhvilluara në institucion, studentët pohuan se merrnin informacion dhe udhëzoheshin në mënyrë të detajuar dhe të vazhdueshme mbi lëndët, përmbajtjen e tyre dhe veprimtaritë formuese. Studentët ishin njohur me rregulloren e programit, syllabuset dhe shpërndarja e informacionit, përveçse mundësohej nga pedagogët në auditor, kryhej edhe përmes fletëpalosjeve, njoftimeve të vendosura në stendat apo monitoret brenda mjediseve të fakultetit (Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze; 5.12 Model broshure informuese).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e	Bazuar në dokumentacionin bazë të paraqitur, takimet me studentët dhe përfaqësues të strukturave përgjegjëse në departamet, GVJ konstaton se zyra për Këshillim Karriere dhe Alumni i orienton studentët drejt tregut të punës dhe mundësive për zhvillimin e karrierës duke u siguruar




punës.	<p>pjesëmarrje në intership-e, workshop-e, panaire dhe konferenca. Gjatë pjesëmarrjes në këto veprimtari studentët kanë mundësi të lidhin kontakte me punëdhënës potencialë. Veprimtaritë me karakter sportiv dhe kulturor u shërbejnë gjithashtu krijimit të lidhjeve dhe bashkëpunimit. Disa nga veprimtaritë e organizuara nga studentët të reflektuara në burimet e vëna në dispozicion nga GVB janë; turneu i futbollit për djem, kampionati sportiv i futbollit për djem, aktivitete sportive volejball, turneu një ditor “Artur Sula” Panairi i Punës “Work and Study” etj. (Ref 1.9 Studim tregu UT; 1.10 Studimi i tregut për FGJ;3.20 Programi i konferencës Second Junior 5.21 Raport mbi aktivitetet kulturore-sportive).</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët gjithashtu rikonfirmuan se informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi veprimtarinë mësimore dhe infrastrukturën e ngritur në mbështetje të saj. Ngarkesa mësimore në auditor gjithashtu bëhet me dije nga ana e stafit që në fillim të vitit akademik. Studentët e programit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Angleze” zhvillojnë përkatësisht; 420 orë leksion në profilin Gjuhë Angleze, 380 orë në profilin Përkthim-Interpretim dhe 490 orë në Studime Britanike dhe Amerikane. Orën e seminareve të zhvilluara përllogariten në 1320 orë për profilin Gjuhë Angleze, 1360 për Përkthim-Interpretim dhe 1250 në Studime Britanike (Ref 5.22 Aneks RVB Ngarkesa totale e studentëve në auditor).</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara me studentët dhe personelin e sekretarisë mësimore, u konfirmua se në fillim të vitit akademik, studentët pajisen me adresë personale email-i përmes së cilës informohen në mënyrë të vazhdueshme me orarin mësimor, datat e provimeve etj. Në kushtet e zhvillimit të mësimimit online, për studentët u krijua mundësia e komunikimit përmes platformës Teams. Komunikimi në distancë u realizua edhe me sekretarinë mësimore.(Ref 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze; 3.2 Rregullore e posaçme për zhvillimin e mësimimit online)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plot përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

GVJ konstaton se FGJH-ja ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. GVJ shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga sekretaria mësimore ku verifikoi se këto të dhëna janë të dokumentuara në regjistrin themeltar të studentëve dhe regjistrin e lëshimit të diplomave. **Ref 5.25 Raport aplikime pranime; 3.5 raport vlerësimi i studentëve të diplomuar)**

Përkatësisht në vite, nota mesatare e studentëve të pranuar në këtë program studimi ka qenë:


- 2018-2019: .7.5
- 2019-2020: 7.6
- 2020-2021: 7.8

Gjatë vizitës në institucion, GVJ shqyrtoi materialet e ruajtura në formë elektronike dhe hard-copy me të dhënat statistikore mbi numrin dhe profilin e studentëve të rregjistruar, nga pranimi deri në diplomim. Mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar. Referuar të dhënave që morëm në institucion mbi numrin e studentëve rezultoi:


Profili	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Gjuhë Angleze	147	195	170	164
Përkthim dhe Interpretim	21	22	21	25
Studime Britanike dhe Amerikane	13	15	25	30
Totali	181	232	216	219

(Ref 2.9 Aneks RVB Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve; 5.25 Të dhëna për diplomimin e studentëve; 4.19 Rregullore brendshme e sekretarisë mësimore)

GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se FGJH dhe DGJA ruan dhe dokumenton statistika vjetore për numrin e studentëve të rregjistruar në programet e ciklit të parë, si dhe tërheqjet dhe largimet nga këto programe studimi. **(Ref 4.19**





	<p>Rregullore e brendshme e sekretarisë mësimore; 2.9 Aneks RVB Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve; 5.25 Të dhëna për diplomimin e studentëve).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të paraqitur për vlerësim, FGJH-ja disponon të dhëna mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të studimeve në ciklin e parë të cilat i ruan dhe dokumenton në regjistrin themeltar të studentëve dhe regjistrin e të dhënave akademike. Nga të dhënat e siguruara përmes dokumentacionit mbështetës rezulton se në këtë program studimi, numri i të diplomuarve është:</p> <p>2018-2019 janë diplomuar 155 studentë; 2019-2020 janë diplomuar 233 studentë; 2020-2021 janë diplomuar 230 studentë;</p> <p>(Ref 2.9 Aneks RVB Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve; 5.25 Të dhëna për diplomimin e studentëve)</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Informacioni i marrë nga GVJ gjatë vizitës në institucion, konfirmoi se të dhënat e ruajtura në regjistrin e arritjeve akademike përputhen me procesverbalet e provimeve dhe të riprovimeve dhe janë të verifikueshme nga personat e autorizuar si pedagogët, kryesekretaret, sekretaret dhe stafi i IT-së. (Ref 5.24 Rregullore UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale)</p> <p>Shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sekretaria mësimore konfirmoi se të dhënat e studentëve ruhen në data basën e sekretarisë dhe në sistemin të brendshëm e-student. Nga verifikimi i regjistrave u konstatua se këto dokumente zyrtarë evidentojnë zhvillimin e orës mësimore dhe frekuentimin nga ana e studentit sipas lëndëve përkatëse, sikurse dhe dokumentojnë temat e zhvilluara për çdo orë mësimi, bazuar tek planet mësimorë. Bazuar tek i njëjti proces verifikimi, vlerësimi i studentëve pasqyrohet në procesverbale të cilat sekretaria mësimore ia ve në dispozicion pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve. Ref 5.26 Udhëzim nr. 16, datë 08.07.2019)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i paraqitur, GVJ konstaton se FGJH-ja harton raport vjetor ku paraqet dhe vlerëson veprimtarinë mësimore, atë shkencore dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit të ofruar nga FGJH. Hartimi i raportit vjetor mbështetet tek udhëzimi i MASR, nr.5, datë 19.02.2018 për “Përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të IAL-së. Raporti paraqet cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje, shkallën e</p>





përmirësimin të këtyre treguesve.	<p>cilësisë së punësimit të tyre dhe masat që duhen ndërmarrë për përmirësimin e këtij të fundit. Zyra e Këshillit të Karrierës dhe Alumni paraqet të dhëna institucionale në lidhje me punësimin e studentëve të FGJH-së. (Ref 1.15 Raport vjetor i FGJH-së 2019-2020; 1.16 Raport vjetor i FGJH-së 2020-2021)</p> <p>Bazuar te të dhënat e siguruar përmes dokumentacionit të paraqitur mbi studimin e tregut të punës, rezultojnë se për vitin akademik 2020-2021 në portalin “Mësues për Shqipërinë” janë punësuar 349 mësues të gjuhës angleze të diplomuar pranë FGJH-së. Duke iu referuar të njëjtit burim nga QSHA-ja, numri i studentëve aplikantë në portal është 707 për kandidatët që aplikojnë për herë të parë dhe 248 për riaplikantët. Në lidhje me të dhënat mbi punësimin e përkthyesve, sipas Agjencisë së Përkthimit dhe Shtëpive Botuese, 65% e të punësuarve pranë agjencive të intervistuar ishin studentë të diplomuar në gjuhën angleze në FGJH. Statistikat e siguruar nga raportimet e Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me numrin e përkthyesve të rregjistruar, raportojnë për 85 përkthyes të gjuhës angleze me certifikatë sigurie dhe 261 pa certifikatë sigurie. Përfundimet e nxjerra nga ky studim nuk japin shifra konkrete se sa nga këta përkthyes janë të diplomuar në FGJH. (Ref 1.10 Studimi i tregut të punës FGJH; 5.25 Të dhëna për diplomimin e studentëve).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi V.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimin të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë</p>	<p>Bazuar në statutin e institucionit, prania e përfaqësuesve të studentëve është e sanksionuar në të gjitha organet kolegjiale të tij. Studentët gëzojnë të drejtën e vendimarrjes bazuar në LAL, nr.80/2015, neni 99 dhe në Statutin e UT-së. Studentët kishin informacion të plotë mbi të drejtën e përfaqësimit në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit, në</p>





IAL-ve.	Senatin Akademik, Komisionin e Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me studentët, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës, Këshillin e Etikës dhe në Këshillat e Studentëve. (Ref. 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës; 5.27 Vendim nr. 9, datë 11.04.2019).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Gjatë takimeve që studentët zhvilluan me GVJ, ata konfirmuan faktin se përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Senatit Akademik, kanë të drejtë diskutimi dhe të drejtë vote të barabartë me anëtarët e tjerë. Studentët u shprehën se ata marrin pjesë aktive në komisionet e ngritura pranë institucionit dhe se stafi akademik dhe ai mbështetës inkurajojnë angazhimin e tyre në të gjitha veprimtaritë e organizuara. Studentët bëhen pjesë e veprimtarive shkencore si konferenca kombëtare, ndërkombëtare, seminare dhe trajnime të ndryshme.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Ngarkesa e veprimtarisë mësimore për studentët që ndjekin programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Gjuhë Angleze” është 6 semestra të shpërndarë në 3 vite akademike, e shprehur në kredite me 60 kredite për vit. Në varësi të ndryshimeve të parashikuara në ligj, më konkretisht VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. FGJH-ja ka reflektuar ndryshime të programeve me qëllim përmirësimin e tyre. Referuar dokumentacionit të sjellë nga GVB, rezultojnë se komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit për transferim, kryen procedurat e njohjes së studimeve apo kualifikimeve të mëparshme, të transferimit të studimeve, regjistrimit në një program të dytë studimi apo ripranim. E njëjta procedurë kryhet në rastet e mobiliteteve. Në raste shkëmbimi, DGJA kryen procedura e njohjes së studimeve për periudhën gjatë së cilës është kryer mobiliteti. Nga dokumentacioni i shqyrtuar u vërejt se gjatë vitit akademik 2018-2019 janë kryer 10 transferime, 12 ekuivalentime dhe 2 studentë janë përfshirë në programet e mobilitetit në kuadër të programit Erasmus+ . Bazuar tek i njëjti dokumentacion, të dhënat për vitet e tjerë akademike janë si më poshtë; 2019- 2020 -1 transferim, 7 ekuivalentime dhe 3 shkëmbime Erasmus; 2020-2021- 1 transferim, 10 ekuivalentime dhe 2 bursa Erasmus (Ref. 5.15 Shkresë Komisin për pranimin e kandidatëve; 5.18 Shkresë për ngritjen e komisiinit të ekuivalentimit; 5.30 Numri i studentëve transferime ekuivalentime mobilitet).




<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të programit të studimit realizohet kryesisht nëpërmjet pyetësorëve që u drejtohen studentëve. Raportet e sigurimit të cilësisë hartohen bazuar në të dhëna të marra nga pyetësorët e studentëve të cilët shprehin mendimet dhe vlerësimet e tyre në lidhje me lëndët dhe shërbimet e ofruara për ta nga institucioni. Gjatë takimit që GVJ kreu me studentët, ata u shprehën se ndiheshin të përfshirë dhe të angazhuar në proceset vendimarrëse të departamentit dhe se vlerësimi i mendimeve të tyre bëhej objektivisht, duke ju siguruar barazi dhe paanshmëri. (Ref. 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës; 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze; 1.20.2 Paketa e instrumentave të cilësisë; 5.31 Model formati pyetësori për studentët; 5.32 Raport i vlerësimit të studentëve për mësimin në distancë; semestri I; 5.33 Raport i vlerësimit të studentëve për mësimin në distance, semestri II) Ref. 3.4 Model formati pyetësori për studentët ; 3.5 Raport vlerësimi i studentëve të diplomuar 2020-2022)</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Kuadri rregullator i DGJA-së u siguron studentëve mundësinë për të ankimuar rezultatin e vlerësimit të kontrollit të dijeve, si dhe të drejtën për të kërkuar rishikim apo rivlerësim. Pas përfundimit të afatit të ankimimit, notat hidhen në sistemin e-student. Gjatë takimit që GVJ realizoi me grupin e studentëve, ata u shprehën se ishin plotësisht të informuar me mundësinë e ankimimit, madje ndanë dhe përvojat e tyre për rastet në të cilat ata e kishin ushtruar këtë të drejtë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në</p>	<p>Referuar dokumentacionit të paraqitur nga GVB, studentëve u sigurohet e drejta për informim dhe për këtë qëllim institucioni ka ngritur strukturën e Zyrës së Karrierës dhe Zyrës së Informacionit. Studentët informohen që në fillim të</p>




<p>përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>vitit të parë akademik mbi programet e studimit, organizimin dhe përmbajtjen e tij, kohëzgjatjen, akreditimin, mundësitë për diplomim, kalendarin akademik, sezonin e provimeve dhe informacione të tjera të nevojshme. Gjatë takimit e GVJ me grupin e studentëve, këta të fundit, vlerësuan transparencën e siguruar gjatë dhënies së informacionit dhe ritheksuan disa nga mënyrat me të cilët ata e merrnin informacionin nga institucioni si p.sh përmes takimeve me stafin akademik, sekretarisë mësimore, zyrës së informacionit, email-it personal, platformës Teams, faqes zyrtare të FGJH-së, rrjetit social Facebook, stendës së informacionit dhe monitorëve të vendosur në mjediset e Godinës A. (Ref 1.2 Statuti i Universitetit të Tiranës; 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze; 2.1 Rregullore e Universitetit të Tiranës; 5.20 Rregullore e zyrës për Këshillimin e Karrierës).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstaton se informimi dhe këshillimi i studentëve kryhet përmes disa strukturave si Drejtoria e Marrëdhënieve me Studentët dhe Publikun, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, sekretarive, këndit të njoftimeve, broshurave informative. Gjatë vizitës, studentët rikonfirmuan faktin se i gjithë personeli akademik angazhohet dhe ofron mbështetjen e duhur për çështje që lidhen me programin e studimit, procesin mësimor dhe u vjen në ndihmë studentëve përmes seanceve të konsultimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me grupin e studentëve dhe përfaqësues të zyrës për Këshillimin e Karrierës, GVJ konstatoi se kjo strukturë ofron informacion në lidhje me veprimtarinë mësimore, oraret e konsultimit, përzgjedhjen e degëve për programin Master, zgjedhjet për praktikën profesionale dhe orientimin në tregun e punës. (Ref. 5.20 Rregullore e zyrës për Këshillimin e Karrierës)</p> <p>Studentët theksuan faktin se zyra për këshillimin e karrierës i informon ata në lidhje me organizime të ndryshme si konferenca, trajnime, projekte dhe veprimtari të tjera social-kulturore dhe artistike. (Ref. 1.9 Studim tregu UT; 1.10 Studim tregu FGJH; 5.21 Raport mbi aktivitetet kulturore-sportive)</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën</p>	<p>Zyra për Këshillimin dhe Karrierën mban kontakte me studentët e diplomuar dhe informon organet dhe autoritetet drejtuese mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve. Nga informacioni i siguruar rezulton se nota mesatare e</p>

dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	studentëve të diplomuar në programin e ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Angleze” është 7.5 në vitin akademik 2018-2019; 7.5 në 2019-2020, 7.6 në 2020-2021 dhe 7.8 në vitin akademik 2021-2022. Specialistja e Zyrës për karrierën kontakton studentët përmes email-it, numrit të telefonit dhe rrjeteve sociale dhe harton relacione ku përmbledh të dhënat mbi punësimin e tyre. Këto raporte publikohen në faqen zyrtare të FGJH-së. (Ref. 1.9 Studim tregu UT; 1.10 Studim tregu FGJH; 5.20 Rregullore e zyrës për Këshillimin e Karrrierës; 5.25 Të dhëna mbi diplomimi dhe punësimin e studentëve, Tabela 23)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Notë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ, bazuar në dokumentacionin shoqëruar në RVB, si edhe nga vizita në institucion konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë publik, UT, ka parashikuar struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Mbështetur në Statutin e tij, GVJ evidenton se institucioni ka ngritur: <ol style="list-style-type: none"> 1. Njësinë për Sigurimin e Cilësisë (NJSC), në (UT); 2. Komisionin e Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë (KPSSC) të UT-së; 3. Grupet e Vlerësimit të brendshëm të institucionit (grupe ad-hoc) për periudhën e akreditimit institucional, si edhe ka parashikuar për njësitë kryesore ngritjen e NJSBC-ve; 4. GVB-të për vlerësimin e programeve të studimit;
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe	




<p>bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>(REF 1.2 Statuti i UT-së, Neni 15/neni21/ 140-141; Ref 6.5 Vendim për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të UT-së).</p> <p>Universiteti i Tiranës ka miratuar me vendim Senati Akademik Rregulloren për sigurimin e Cilësisë në UT, (Ref. 1.20, Rregullore për sigurimin e Cilësisë Neni 3), e cila përcakton Fushën e veprimtarisë dhe efektin të shtrirë mbi të gjithë organet drejtuese, strukturat akademike/ndihmës akademike/ njësitë bazë, personelin akademik/ndihmës, personelin administrativ dhe studentët. Gjithashtu, GVJ konstaton se në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit të UT- së, në lidhje me sigurimin dhe përmirësimin e standarteve të cilësisë janë hartuar politika të posaçme në këtë drejtim. GVJ evidenton se UT ka hartuar të gjithë dokumentat rregullatorë, të cilat duhet të zbatohen nga njësitë kryesore, (Ref 1.20.1 Manuali i Cilësisë/Ref. 1.20.2 Paketa e Instrumentave të Cilësisë).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues të tij, GVJ evidenton se UT ka përdorur instrumentat e duhur për sigurimin e cilësisë duke bashkëvepruar me institucione që ofrojnë vlerësim të jashtëm për sigurimin e cilësisë. Institucioni më i rëndësishëm në këtë proces është Agjensia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Univeristeti i Tiranës, ka patur dy procese të vlerësimit të jashtëm nga ASCAL, në kuadër të akreditimit periodik institucional. Aktualisht është i akredituar me Vendim Nr .84 të BA, 27.10 .2018 (Ref. Akreditimi periodik i Universitetit të Tiranës www.unitir.edu.al). GVJ konsaton se studentët e UT-së, me qëllim vlerësimin e mësimdhënies dhe aspekteve të tjera në funksion të saj, në bashkëpunim me ASCAL, kanë realizuar sondazhin kombëtar të studentëve (Ref. Faqja zyrtare UT www.unitir.edu.al). GVJ konstaton se UT në zbatim të instrumentave për sigurimin e cilësisë dhe në funksion të procesit të akreditimit të institucionit ka qenë rregullisht pjesë e trajnimeve dhe takimeve me ekspertë të jashtëm për Grupet e Vlerësimit të Brendshëm, por edhe me struktura të tjera brenda institucionit për efekt të përmirësimit të politikave të brendshme të UT-së dhe përditësimit të informacionit, (Ref. Faqja zyrtare UT: www.unitir.edu.al)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB-së, konstaton se UT ka parashikuar struktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë të programeve të studimit. Mbështetur në Statutin e tij, UT ka ngritur Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës, strukturë e cila është përgjegjëse</p>




studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

për vlerësimin e Projekt- Programeve (**Ref 1.2 Statuti i UT-së, Neni 42**). Referuar RVB, struktura kryesore për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që UT ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është Drejtoria e Kurrikulave dhe sigurimit të Cilësisë UT, (**Ref. (Ref. Faqja zyrtare UT, Struktura organizative www.unitir.edu.al.)**)

GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqërues në DVV dhe nga vizita në institucion se FGjH në mbështetje të "Rregullores së Cilësisë të Universitetit të Tiranës" dhe në dokumenta rregullatorë në nivel njësie kryesore, (FGjH) ka në organigramën e saj Degën e Cilësisë, Vlerësimit dhe Kurrikulës, strukturë e përbërë nga staf ndihmës akademik në varësi të Dekanit, NJSBC-në dhe grupin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze (grup ad-hoc në kuadër të procesit të akreditimit të programeve të studimit) (**Evidence 1.20 Rregullore per sigurimin e cilesise UT;**(Ref 3.11 Urdhër i brendshëm për ngritjen e NJSBC-së).

Këto struktura kanë akses në të gjitha të dhënat e institucionit. GVJ konstaton se NJSBC si strukturë në nivel njësie kryesore, nëpërmjet procedurave të Manualit të Cilësisë UT dhe aplikimit të Paketës së Instrumentave kanë hartuar raporte me analizën e të dhënave të grumbulluara nga studentët dhe pedagogët, të cilat u bëhen të ditura tek drejtuesit e FGJH dhe më pas përgjegjësit të DGjA (**Ref. 6.6 Rregullore për funksionimin e NJSBC në FGJH, 2022**).

GVJ, Referuar RVB-së, konstaton se në kuadër të politikave të qarta të UT-së për vlerësimin periodik të njësive kryesore të tij dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit, ka zhvilluar një proces auditi të brendshëm, për FGJH për periudhën kohore 2016-2018. (**Ref. 4.7 Raporti përfundimtar i auditimit 2021 fq 2425.pdf**).

UT, gjithashtu ka kryer Studimin e tregut të punës për studentët aktualë dhe Alumni, me qëllim identifikimin e cilësisë së programeve të studimit që ofron. (**Ref.1.9 Studimi i tregut të punës, UT**).

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.2


Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngrë njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe materialit mbështetës të tij, GVJ konstaton se FGJH si njësi kryesore ka ngritur në vitin 2021 Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si strukturë e posaçme për garantimin dhe sigurimin e standarteve të cilësisë në nivel fakulteti, mbështetur në Statutin e UT-së (<i>neni 141</i>). NJSBC është e përbërë nga 5 anëtarë personel akademik të FGJH dhe 2 studentë, (Ref 3.11 Urdhër i brendshëm për ngritjen e NJSBC-së). Për mirëfunksionimin e saj, NJSBC mbështetet në Rregulloren e posaçme (Ref. 6.6 Rregullore për funksionimin e NJSBC në FGJH, 2022).</p> <p>GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqërues dhe vizita në institucion se vlerësimi i Programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze kryhet nga NJSBC dhe Dega e Cilësisë, Vlerësimit dhe Kurrikulës. Gjithashtu duke iu referuar RVB-së, vlerësimi i Programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze realizohet nga grupet e vlerësimit të brendshëm të ngritura nga Departamentet, të cilat pasi realizojnë procesin e vlerësimit mbështetur në Manualin e Cilësisë, hartojnë raportin përkatës. GVJ konstaton se NJSBC është strukturë përgjegjëse për administrimin e procesit të vlerësimit, përpilimin dhe analizimin e raporteve vjetore apo raporteve të tjera, të cilat shërbejnë si bazë të dhënash për DGJA. NJSBC harton dhe koordinon veprimtarinë e saj për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies me departamentin e gjuhës angleze, (Ref. 1.6 Rregullore e programit të studimi Bachelor Gjuhë Angleze, Neni 21; Ref. 1.20.1 Manuali i Cilësisë).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB-së dhe dokumentacioni shoqërues i tij, GVJ evidenton se FGJH përdor mekanizma formale e të dokumentuar për shqyrtimin dhe mbikëqyrjen periodike të Programit Bachelor në gjuhë angleze, sic janë: 'Manuali i Cilësisë' dhe 'Paketa e instrumentave të miratuar nga UT', (Ref. 1.20.1 Manuali i Cilësisë; Ref.1.20.2 Paketa e instrumentave të cilësisë). FGJH përdor metoda të drejtpërdrejta për sigurimin e standarteve të cilësisë si pyetësorët periodikë të studentëve, anketime me të diplomuar, personelin akademik, punëdhënësit për studentët e diplomuar</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe</p>	


<p>vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>nga UT. Duke iu referuar RVB, konstatohet se FGJH ka ngritur grupe pune për vlerësimin e mësimin në distancë përgjatë periudhës së pandemisë, duke administruar elektronikisht një pyetësor për studentët e programit Bachelor në Gjuhë angleze, i cili paraprakisht është miratuar në Dekanat. (Ref. 5.31 Model Pyetësori për mësimin në distancë).</p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ, pasi shqyrtoi dokumentacionin mbështetës, konstatoi se rezultatet e vlerësimeve dokumentohen në formën e raporteve në nivel universiteti (Ref 6.8 Raport i veprimtarisë mësimore - shkencore/ kërkimore të UT, 2019-2020; Ref.6.10 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë, UT, 2020-2021) dhe në nivel njësie kryesore (FGJH) për periudha kohore semestrale ose vjetore, të hartuara nga NJSBC, të cilat raportohen në Dekanat. (Ref. 5.32 Raport vlerësimi i studentëve për mësimdhënien në distancë Sem I-re, 2020-2021; Ref 5.33 Raport vlerësimi i studentëve për mësimdhënien në distancë Sem II. 2020-2021; Ref 6.11 Raport vlerësimi nga personeli akademik).</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Referuar RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se raportet e hartuara në nivel njësie kryesore (Fakulteti i Gjuhëve të huaja) u bëhen të njohura autoriteteve drejtuese të UT-së (Ref.1.15 Raport Vjetor i FGJH për vitin akademik 2019-2020 Ref.1.16 Raport Vjetor i FGJH për vitin akademik 2020-2021).</p> <p>GVJ konstaton se në dokumentacionin shtesë depozituar nga IAL, vërehet kryerja e procedurës së plotë për publikimin e raporteve të hartuara nga NJSBC dhe Dega e Cilësisë, Vlerësimit dhe Kurrikulës drejtuar organeve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit, (Ref.Dok. Shtesë, Nr. 8, Shkresë, përcjellja e Raportit përmbledhës të studentëve të diplomuar Dhjetor 2021; Ref.Dok. Shtesë, Nr. 9 Shkresë, përcjellja e Raportit Vjetor 2020-2021).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.3


Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Referuar RVB dhe dokumentacionit shoqëruar të tij, GVJ konstaton se FGJH në vitin 2021 ka ngritur NJSBC-në si strukturë monitoruese për sigurimin e cilësisë në nivel të fakultetit të gjuhëve të huaja, e cila, në mënyrë të paravarur mbledh të dhëna dhe kryen analiza, ndër të tjera edhe për programet e studimit (Ref 3.11 Urdhër i brendshëm për ngritjen e NJSBC-së).</p> <p>GVJ konstaton sipas RVB dhe vizitës në institucion se raportet e hartuara nga NJSBC, ndihmojnë koordinatoret e programeve të studimit dhe grupet mësimore–kërkimore të reflektojnë mbi përmirësime potenciale të programeve të studimit. Këto vlerësime janë të përvitshme dhe përmbillen me raportin e vetëvlerësimit që përcillet zyrtarisht në Dekanat me rekomandimet përkatëse. (Ref.5.32 Raport vlerësimi i studentëve për mësimdhënien në distancë Sem I 2020-2021. Ref 5.33 Raport vlerësimi i studentëve për mësimdhënien në distancë, Sem I, 2020-2021. Ref 6.11 Raport vlerësimi nga personeli akademik viti akademik 2020-2021. Ref. 6.10 raport vjetor për vlerësimin e cilësisë).</p> <p>GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqëruar se raportet e hartuara nga NJSBC përmbajnë të dhëna në nivel njësie kryesore, (FGJH), dhe jo veçanërisht për Programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze dhe janë kryesisht për periudhën e zhvillimit të mësimin në distancë viti akademik 2020-2021. GVJ konstaton se raporti i vlerësimit të brendshëm përcillet nga Dekani tek përgjegjësi i DGjA (Ref. 3.5 Raport Vlerësimi i studentëve të diplomuar, viti akademik 2020-2021)</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni përdor metoda të posaçme dhe të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit të studimit, sic janë: aplikimi sondazhit për studentët e diplomuar viti 2020-2021 dhe anketimi i agjensive, organizatave dhe shoqërive të punësimit të përfshira në studimin e tregut të punës me të diplomuarit nga FGJH. (Ref.1.9 Studimi i tregut të punës, FGJH; Ref. 3.5 Raport Vlerësimi i studentëve të diplomuar, viti akademik 2020-2021).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit</p>	<p>GVJ konstaton duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB se DGjA në kuadër të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit përdor disa metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies,</p>




<p>përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>vlerësim i didaktikës, kurrikulës. Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se Përgjegjësi i DGJA në bashkëpunim me stafin akademik çdo fillim viti akademik mer në shqyrtim programet mësimore, për ndonjë ndryshim të nevojshëm në varësi të rekomandimeve nga studentët dhe stafi akademik, po ashtu, ai cakton grupet mësimore dhe kërkimore dhe në bashkëpunim realizon diskutime, si dhe vëzhgime në auditor me efekt përmirësimit e procesit mësimor (Ref.1.1 Statuti i UT-së).</p> <p>GVJ konstaton referuar RVB-se dokumentacionit shoqërues dhe vizitës në institucion, se shkëmbimet maksimale të personelit akademik dhe studentëve programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze me profile: "Gjuhë Angleze", "Përkthim dhe Interpretim", dhe "Studime Britanike dhe Amerikane", në kuadër të Programit Erasmus+, si edhe pranimet e të diplomuarve nga ky program studimi në programe ndërkombëtare të ciklit të dytë në vende të huaja, janë një formë e rëndësishme e vlerësimit të drejtpërdrejtë të cilësisë së kurrikulës, e cila mundëson njohjen e plotë të krediteve të lëndëve dhe moduleve sipas sistemit (ECTS) nga universitetet pritëse. FGJH, për periudhën 2017-2021, ka patur konkretisht 26 mobilitete staf akademik dhe 93 mobilitete studentësh. (Ref 2.15 Shkresë UT-Përcjellja e emrave të stafit dhe studentëve për mobilitetet e kryera 2016-2020).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademi e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, për kryerjen e vlerësimit, GVJ konstaton se përveç formave të lartpërmendura për vlerësimin dhe garantimin e standarteve të cilësisë së programit, FGJH ka përdorur një metodologji komplekse, duke interguar në procesin e vlerësimit të cilësisë të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, nisma institucionale të vlerësimit si: Studimi i tregut të punës dhe Vlerësimi i studentëve të diplomuar nga DGJA për vitin akademik 2020 -2021 (Ref.1.10 Studimi i tregut të punës 3.5 Raporti i vlerësimit të studentëve të diplomuar 2020-2021). Po ashtu, GVJ vëren se realizohet raporti për vlerësimin nga personeli akademik (Ref 6.11 Raport përmbledhës mbi pyetëtorin "Formular vlerësimi nga personeli akademik viti 2020-2021).</p> <p>GVJ konstaton se të tilla studime dhe matje reflektojnë angazhimin e institucionit në nivel njësie kryesore për të thelluar informacionin mbi programet në rrafshin praktik, por këto monitorime duhet të lidhen më ngushtësisht me programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, duke</p>




	reflektuar rekomandimet dhe konkluzionet nga raportet e mëparshme të vlerësimit, si dhe të kryhen në formë periodike për çdo vit akademik, pasi janë të përqëndruar kryesisht për vitin akademik 2020-2021. (Ref. 5.32 Raport vlerësimi i studentëve i mësimdhënies në distancë, sem 1; Ref. 5.33 Raport vlerësimi i studentëve i mësimdhënies në distancë, sem 2, viti akademik 2020-2021; Ref 6.11 Raport përmbledhës mbi pyetësin "Formular vlerësimi nga personeli akademik viti 2020-2021, Ref. 6.10: Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë).			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se UT parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Institucioni ka ngritur KPSSC me përfaqësi nga fakultete, institute, struktura të sigurimit të cilësisë në Rektorat dhe studentët (Ref 1.2 Statuti UT. Ref 1.20: Rregullore NJSBC Neni 5/ pika 1 dhe 2, Ref 6.3: Zgjedhja e Komisioneve të Përhershme Institucionale dhe të Këshillit të Etikës në UT. Pika 3) <i>Referuar dokumentacionit shoqërues në RVB rezultojn se NJSBC është ngritur në vitin 2021 (Ref 3.11 Urdhër i brendshëm për ngritjen e NJSBC-së). Veprimtaria dhe strukturimi i kuadrit të vlerësimit të cilësisë në FGjH i përket kryesisht vitit 2020-2021. GVJ vëren se të tilla veprimtari duhet të marin karakter periodik. (Ref. 3.5 Raport Vlerësimi i studentëve të diplomuar, viti akademik 2020-2021; Ref 3.11 Urdhër i brendshëm për ngritjen e NJSBC-së).</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe	GVJ konstaton se UT përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave, dhe ka rekomanduar ngritjen e këtyre strukturave pranë fakulteteve. Konkretisht, GVJ konstaton se FGJH e ka

<p>garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>ngritur NJSBC, si dhe grupet e vlerësimit të brendshëm për njësinë bazë, DGJA. Po ashtu, FGJH ka hartuar Rregulloren për funksionimin e NJSBC, në të cilën parashikohen detyrat dhe përgjegjësitë për anëtarët e Njesisë dhe drejtuesin e saj (Ref. 1.20 Rregullore për sigurimin e Cilësisë Neni 21/22/26/27/; (Ref. 6.6 Rregullore për funksionimin e NJSBC në FGJH, 2022, neni 5/ pika 1 dhe 2).</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UT përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave (Ref. 1.20 Rregullore për sigurimin e Cilësisë Neni 21/22/26/27/; (Ref. 6.6 Rregullore për funksionimin e NJSBC në FGJH, 2022, neni 5/ pika 1 dhe 2).</p> <p>GVJ konstaton se në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, se FGJH ka ngritur Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të njësisë bazë, (DGJA), i përbërë nga: (6) anëtarë personel akademik dhe (1) një student i programit të studimit bachelor në gjuhë angleze. Kryetari i grupit është i kategorisë Profesor. (Ref. 3.12.1 Përgjigje e shkresës-Ngritja e GVB-së). Gjithashtu, GVJ vëren se është ngritur struktura e NJSBC-së në nivel fakulteti e përbërë nga: (5) anëtarë personel akademik dhe (2) dy studentë. Ref 3.11 Urdhër i brendshëm për ngritjen e NJSBC-së). Përveç këtyre strukturave të posaçme për sigurimin e cilësisë, në organigramën e FGJH është përfshirë Dega e Cilësisë, Vlerësimit dhe Kurrikulës me staf ndihmës akademik që asiston në garantimin e standarteve të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. (Ref. Struktura Organizative e FGjH: unitir.edu.al/struktura-organizative-e-fakultetit-te-gjuheve-te-huaja/www.fgjh.edu.al).</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, se FGJH ka ngritur Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të njësisë bazë, (DGJA), i përbërë nga: (6) anëtarë personel akademik dhe (1) një student i programit të studimit bachelor në gjuhë angleze. Kryetari i grupit është i kategorisë Profesor. (Ref. 3.12.1 Përgjigje e shkresës-Ngritja e GVB-së). Gjithashtu, GVJ vëren se është ngritur struktura e NJSBC-së në nivel fakulteti e përbërë nga: (5) anëtarë personel akademik dhe (2) dy studentë. Ref 3.11 Urdhër i brendshëm për ngritjen e NJSBC-së). Përveç këtyre strukturave të posaçme për sigurimin e cilësisë, në organigramën e FGJH është përfshirë Dega e Cilësisë, Vlerësimit dhe Kurrikulës me staf ndihmës akademik që asiston në garantimin e standarteve të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. (Ref. Struktura Organizative e FGjH: unitir.edu.al/struktura-organizative-e-fakultetit-te-gjuheve-te-huaja/www.fgjh.edu.al).</p> <p>Mbështetur në këto evidenca, GVJ konstaton se përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, (Ref. 6.6 Rregullore për funksionimin e NJSBC në FGJH, 2022; Ref. 6.14 Programi i Transparencës UT).</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, përsa i përket procesit të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë GVJ konstaton se është referuar aktiviteti i Zyrës për Këshillimin dhe Karrierën, por kjo zyrë ka karakter orientues</p>


<p>ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>kryesisht për tregun e punës së studentëve dhe angazhimin dhe jetën studentore. GVJ konstaton se është Zyra e Cilësisë, Vlerësimit dhe Kurrikulës me staf ndihmës akademik që asiston në garantimin e standarteve të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze.</p> <p>Në strukturat e ngritura në nivel institucioni UT dhe Njësive kryesore (FGJH), GVJ konstaton se në përbërje të strukturave të sigurimit të Cilësisë nuk ka bashkëpunëtorë ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit (<i>Ref. 3.12.1 Përgjigje shkresës 'Ngritja e GVB-së'; Ref 3.11 Urdhër i brendshëm për ngritjen e NJSBC-së; Ref 6.3 Zgjedhja e Komisioneve të Përherëshme Institucionale dhe të Këshillit të Etikës në UT, Pika 3).</i></p> <p><i>GVJ sugjeron mundësinë për ngritjen e bordeve këshillimore me ekspertë të jashtëm sipas fushës së studimit Bachelor në Gjuhë Angleze që mund të kontribuojnë me ekspertizën e tyre për përmirësimin e programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmb.</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.5</p>	
<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i informacionit dhe referencës përkatëse të paraqitur në RVB, GVJ, konstaton se organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të Fakultetit të Gjuhëve të huaja. (Ref. Faqja elektronike zyrtare https://fgjh.edu.al/plani-i-veprimit-per-vitin-2021-2022/)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstaton nga vizita në institucion (takimi me pedagogët) se procesi i mëtejshëm i publikimit të të dhënave për vlerësimin e personelit akademik bëhet individualisht nëpërmjet komunikimit elektronik duke respektuar konfidencialitetin e tyre. (Ref. 6.11 Raport vlerësimi nga personeli akademik.pdf).</p>




	<p>GVJ konstaton nga vizita në institucion (takimi me përgjegjësin e departamentit dhe përfaqësues të Zyrës së Cilësisë) se rezultatet e raporteve të përpiluara nga strukturat e posaçme të monitorimit të cilësisë, u përcillen Dekanit dhe përgjegjësit të DGjA. Gjetjet nga raportet bëhen publike dhe diskutohen në department.</p> <p>(Ref. 3.5, Raport vlerësimi i studenteve të diplomuar, viti akademik 2021-2022.pdf; Ref. Dokumentacion shtesë, Pika 8.Shkresë percjellja e Raportit permblledhes te studenteve te diplomuar dhjetor 2021.pdf; Pika 9 Shkresë percjellja e Raportit Vjetor 20-21, cilesia.pdf</p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstaton se rezultatet e vlerësimit shoqërohen me rekomandime, të cilat adresojnë problematikat e hasura në gjetjet e analizës së të dhënave të grumbulluara. (Ref 6.11 Raport përmbledhës mbi pyetësorin "Formular vlerësimi nga personeli akademik viti 2020-2021", Ref.6.10 Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni (UT) ka bërë përpjekje të vazhdueshme nëpërmjet ndërtimit të kuadrit rregullator, strukturave dhe politikave për sigurimin e standarteve të cilësisë për programet e studimit. Në përputhje me kuadrin rregullator dhe atë politikave për sigurimin e cilësisë të UT-së, GVJ konstaton se njësia kryesore, FGJH, po ashtu ka integruar veprimtarinë e tij në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel fakulteti dhe njësie bazë. (Ref. 6.6 Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Vendim nr.54). FGJH ka organizuar në bashkëpunim me ASCAL aktivitete për studentët dhe personelin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit (Ref. VKM, Nr.824, Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë. https://www.ascal.al/sq/sigurimi-i-cilesise/kodi-i-cilesise).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor "Bachelor në "Gjuhë Angleze" me profile në: "Gjuhë Angleze", "Përkthim dhe Interpretim" dhe "Studime Britanike dhe Amerikane"

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Hartimi dhe ofrimi me sukses i programit të studimit Bachelor në: "Gjuhë Angleze" me profile në: "Gjuhë Angleze", "Përkthim dhe Interpretim" dhe "Studime Britanike dhe Amerikane" në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit dhe Studimin e Tregut të punës të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, që reflektohet tek numri i lartë i studentëve, të cilët zgjedhin këtë program studimi dhe që punësohen pas përfundimit të tij.
2. Ngritja dhe mirë funksionimi i disa strukturave ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore (FGjH) të tilla si: "Dega e Cilësisë, Vlerësimit dhe Kurrikulës", "NJSBC", "Dega e Kualifikimit shkencor dhe Botimeve", "Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit pedagogjik" dhe "Dega e Projekteve", në dobi të ruajtjes dhe rritjes së cilësisë të programit të studimit.
3. Numri i lartë i personelit akademik efektiv për programin e studimit (mbi 90%) të pajisur me grada shkencore.
4. Vizioni i institucionit (FGjH) për hartimin e politikave bashkëkohore siç është Strategjia e Teknologjisë dhe Inovacionit në mësimdhënie e nxënie, e cila ka garantuar maksimalisht zhvillimin e infrastrukturës dhe digjitalizimin e sistemit të brendshëm të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në funksion të programit të studimit.
5. Ofrimi i bibliotekës fizike në ambjentet e institucionit me hapësira të bollshme shfrytëzimi për lexim dhe studim të literaturës, si edhe atyre elektronike me një numër shumë të pasur titujsh në gjuhën angleze në funksion të programit të studimit.
6. Ndërkombëtarizimi i institucionit (FGjH) i shprehur me standartizimin e kurrikulës së programit të studimit me programe të ngjajshme në universitetet ndërkombëtare homologe dhe me mobilitetin e lartë të stafit dhe studentëve në kuadër të projekteve ndërkombëtare ku institucioni është partner.
7. Përfshirja e studentëve në strukturat e posaçme për sigurimin e standarteve të cilësisë në programin e studimit.
8. Krijimi i rrjetit "Alumni" dhe realizimi i studimit të Tregut të Punës, për programin e studimit, nëpërmjet të cilit FGjH ka gjurmuar të dhëna mbi punësimin dhe aktivizimin e të diplomuarve të tij, duke i shfrytëzuar për përmirësimin e kurrikulave të programit të studimit.
9. Hapja e disa qendrave në institucion të cilat shërbejnë për shërbime ndaj të tretëve si: qendra e gjuhëve të huaja, qendra e trajnimit dhe qendra e përkthimeve, mirë funksionimi i të cilave, ka rritur potencialin e institucionit në drejtimin financiar dhe atë komunitar.



b. Pika të dobëta:

1. Nevoja e standartizimit të emërtimit të saktë të programit të studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" sipas profileve "Gjuhë Angleze", "Përkthim dhe Interpretim" dhe "Studime Britanike dhe Amerikane" në burimet dhe aktet nënligjore që lidhen me arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, si: Portali U-Albania, VKM-të për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, etj. **(Standarti I.2-Kriteri 3)**
2. Një pjesë e konsiderueshme e literaturës së detyrueshme/bazë në sylabuset e lëndëve të Programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" nuk është e përditësuar me botime të dekadës së fundit, si edhe nuk rekomandon burimet e bibliotekave on-line që ofrohen nga UT. **(Standarti II.4-Kriteri 6)**
3. Mungesa e një sistemi digjital për funksionimin e sekretarisë mësimore për lehtësimin e procedurave të ruajtjes, menaxhimit dhe shpërndarjes së të dhënave sikundër dhe ndërvprimin më efikas të kësaj strukture me studentët dhe personelin akademik. **(Standarti III.8- Kriteri 10; Standarti IV.5 - Kriteri 1);**

Rekomandime:


1. GVJ rekomandon se institucioni i arsimit të lartë publik "Universiteti i Tiranës" dhe njësia kryesore "Fakulteti i Gjuhëve të Huaja" në përbërje të tij, duhet të intensifikojnë më tej veprimet zyrtare për standartizimin e emërtimit të saktë të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" me profile në: "Gjuhë Angleze", "Përkthim - Interpretim" dhe "Studime Britanike dhe Amerikane" në të gjitha burimet dhe aktet nënligjore që lidhen me arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë (VKM-të për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, Portali U-Albania), në mënyrë që studenti të përzgjedhë nëpërmjet procesit të transparencës programin e studimit sipas profilit të deklaruar ligjërisht dhe në përputhje me ofertën e programit të studimit nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja;
2. GVJ rekomandon se programet lëndore (sylabuset) e programit të studimit, sidomos në seksionin e literaturës bazë, duhet të përditësohen me botime të pesë viteve të fundit, në varësi të tipologjisë së lëndës, si edhe të vlerësohet mundësia e rekomandimit të burimeve elektronike të literaturës, siç janë bibliotekat on-line që ofron institucioni;
3. GVJ rekomandon aktivizimin e një sistemi elektronik digjital të funksionimit të sekretarisë mësimore për lehtësimin e procedurave të komunikimit të të dhënave dhe vlerësimit të studentëve nëpërmjet aksesit nga llogaritë e tyre elektronike zyrtare;
4. GVJ rekomandon se, pavarësisht kuadrit rregullator ligjor të plotësuar në funksion të programit të studimit, Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (miratuar në vitin 2010) duhet të përditësohet në përputhje me ndryshimet në Ligjin Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë";
5. GVJ rekomandon përfshirjen në planin mësimor, kategoria D, të praktikës profesionale në kuadër të përmbushjes së udhëzimeve të parashikuara në VKM, nr 41, datë 24.01.2018 për "Elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL";



Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program "Bachelor in English Language" with profiles in: "English Language", "Translation and Interpreting" and "British and American Studies"

a. Strengths and Affirmations:

1. The successful designation and implementation of the Bachelor study program in: "English Language" with profiles in: "English Language", "Translation and Interpreting" and "British and American Studies" in accordance with the Development Strategy and Labor Market Research of the Faculty of Foreign Languages, which is reflected in the high number of students enrolled in this study program and who are employed after its completion;
2. The establishment and good functioning of several auxiliary academic structures with an administrative character such as: "Quality, Evaluation and Curriculum Branch", "Internal Quality Assurance Unit, (NJSBC)", "Scientific Qualification and Publications Branch", "Training and Pedagogical Innovation Branch", "The Projects' Branch", at the Foreign Languages Faculty, for the benefit of maintaining and increasing the quality of the study program "Bachelor in "English Language";
3. The high number of effective academic staff for the study program (over 90%) equipped with scientific degrees;
4. The vision of the institution (Foreign Languages Faculty) for the design of contemporary policies such as the "Strategy of Technology and Innovation in teaching and learning" which has guaranteed the maximum development of the infrastructure and the digitalization of the internal system of the Faculty of Foreign Languages, in the implementation of the study program;
5. Providing a physical library in the premises of the institution with abundant spaces for reading and studying literature, as well as electronic ones with a very rich number of titles in the English language in function of the study program;
6. The internationalization of the institution (Foreign Languages Faculty) expressed by the standardization of the curriculum of the study program with similar programs in international counterpart universities and with a high mobility record of staff and students within international projects where the institution is a partner.
7. Involvement of students in special structures for ensuring quality standards in the study program;
8. The establishment of the "Alumni" network and the realization of the study of the Labor Market Research, for the study program, through which Foreign Languages Faculty has tracked data on the employment and activation of its graduates, using it for the improvement of the curricula of the study program;
9. The foundation of several professional centers within the institution offering services to third parties such as: 'the foreign language center', 'the training center' and 'the translation center', the good functioning of which has increased the potential of the institution in the financial and community direction;




b. Weaknesses:

1. The lack of standardization and application of the appropriate name of the Bachelor study program in English Language with profiles in: "English Language", "Translation and Interpreting" and "British and American Studies" in all the regulations related to Higher Education in the Republic of Albania such as U-Albania, Council of Ministers decision for admission quotas in public institutions of higher education in the first cycle Bachelor study programs, etc; (*Standard I.2-Criterion 3*);
2. A significant part of the required literature in the course syllabi of the Bachelor study program in "English Language" is not updated with publications of the last decade. The online library resources provided by UT are not recommended as well. (*Standard II.4-Criterion 6*);
3. The lack of a digital system of operation for the teaching secretariat that would facilitate the procedures of data storage, management and distribution, contributing to a more efficient interaction with the students and academic staff (*Standard III.8- Criterion 10; Standard IV.5 - Criterion 1*);

Recommendations

1. EQA experts recommend that the institution of Higher Education University of Tirana and the Foreign Languages Faculty should further intensify the official actions to standardize the appropriate name of the Bachelor study program in "English Language" with profiles in: "English Language", "Translation and Interpreting" and "British and American Studies" in all the regulations related to Higher Education in the Republic of Albania such as U-Albania, Council of Ministers decision for admission quotas in public institutions of higher education in the first cycle Bachelor study programs, etc. so that the student can select through the transparency process the corresponding study program according to the legally declared profile and in accordance with the opportunities given by the Foreign Languages Faculty;
2. EQA experts recommend that the study program syllabi literature section should be updated with the publications of the last five years according to the typology of the subject. The possibility of recommending electronic sources of literature such as online libraries offered by the institution should also be taken into account;
3. EQA experts recommend the activation of a digital electronic system for the operation of the teaching secretariat in order to facilitate data administration and student assessment procedure, enabling access to their official electronic accounts;
4. Despite the legally completed regulatory framework in function of the study program, the Internal Regulation of the Foreign Languages Faculty (approved in 2010) should be updated in accordance with the changes in Law No. 80/2015 on "Higher Education and Scientific Research in Higher Education Institutions in the Republic of Albania";
5. EQA experts recommend the inclusion of the professional practice in the curriculum, with the aim of meeting the requirements provided in The Council of Ministers decision no. 41, date 24.01.2018 on "Elements of study programs offered by HEIs";



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Asnjë përmbushjen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X